

PROJEKTLIGJ
PËR INTELIGJENCËN ARTIFICIALE¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Qëllimi i këtij ligji është të përmirësojë funksionimin e tregut dhe të mjedisit juridik të Republikës së Shqipërisë, si dhe të promovojë zhvillimin, vendosjen në treg, vënien në shërbim dhe përdorimin e inteligjencës artificiale (IA) të përqendruar te njeriu dhe të besueshme, duke siguruar një nivel të lartë mbrojtjeje të shëndetit, sigurisë, të drejtave themelore, demokracisë, shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes së mjedisit, kundër efekteve të dëmshme të sistemeve të IA-së, si dhe duke mbështetur inovacionin.

2. Ky ligj përcakton:

- (a) rregulla të harmonizuara për hedhjen në treg, vënien në shërbim dhe përdorimin e sistemeve IA;
- (b) ndalime të praktikave të caktuara të IA;
- (c) kërkesa specifike për sistemet e IA-së me rrezik të lartë dhe detyrime për operatorët e këtyre sistemeve;
- (d) rregulla të harmonizuara për transparencën e disa sistemeve IA;
- (e) rregulla të harmonizuara për hedhjen në treg të modeleve të IA me qëllim të përgjithshëm;
- (f) rregulla mbi monitorimin e tregut, mbikëqyrjen e tregut, qeverisjen dhe zbatimin;
- (g) masa për të mbështetur inovacionin, me fokus të veçantë te ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), përfshirë ndërmarrjet fillestare (start-up).

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për:

- (a) ofruesit që hedhin në treg ose vënë në shërbim sisteme të IA-së ose hedhin në treg modele të IA me qëllim të përgjithshëm, pavarësisht nëse këta ofrues janë të vendosur apo të lokalizuar brenda Shqipërisë apo në një vend tjetër;
- (b) përdoruesit e sistemeve IA që kanë vendbanimin ose janë të lokalizuar brenda Shqipërisë

¹ Ky ligj është përafshuar plotësisht me Rregulloren (BE) 2024/1689 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 13 qershorit 2024, e cila vendos rregulla të harmonizuara mbi inteligjencën artificiale dhe ndryshon Rregulloret (KE) Nr. 300/2008, (BE) Nr. 167/2013, (BE) Nr. 168/2013, (BE) 2018/858, (BE) 2018/1139 dhe (BE) 2019/2144 dhe Direktivat 2014/90/BE, (BE) 2016/797 dhe (BE) 2020/1828 (Akt rreth Inteligjencës Artificiale).

- (c) ofruesit dhe përdoruesit e sistemeve IA që kanë vendbanimin ose janë të lokalizuar në një vend tjetër, kur rezultati i prodhuar nga sistemi i IA-së përdoret në Shqipëri;
- (d) importuesit dhe shpërndarësit e sistemeve IA;
- (e) prodhuesit e produkteve që hedhin në treg ose vënë në shërbim një sistem IA së bashku me produktin e tyre dhe nën emrin apo markën tregtare të tyre;
- (f) përfaqësuesit e autorizuar të ofruesve që nuk janë të vendosur në Shqipëri;
- (g) personat e prekur që janë të lokalizuar në Shqipëri.

2. Ky ligj nuk zbatohet për sistemet e IA-së kur dhe për aq sa ato hidhen në treg, vihen në shërbim ose përdoren me ose pa modifikim ekskluzivisht për qëllime ushtarake, mbrojtjeje ose të sigurisë kombëtare, pavarësisht nga lloji i subjektit që kryen ato veprimtari. Ky ligj nuk zbatohet për sistemet e IA-së që nuk hidhen në treg ose vihen në shërbim në Shqipëri, kur rezultati përdoret në Republikën e Shqipërisë ekskluzivisht për qëllime ushtarake, mbrojtjeje ose të sigurisë kombëtare, pavarësisht nga lloji i subjektit që kryen ato veprimtari.

3. Ky ligj nuk zbatohet për autoritetet publike në një shtet tjetër dhe as për organizatat ndërkombëtare që bien brenda fushës së këtij ligji sipas pikës 1, kur ato autoritete ose organizata përdorin sisteme të IA-së në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar ose marrëveshjeve për bashkëpunim në zbatimin e ligjit dhe bashkëpunim gjyqësor në Republikën e Shqipërisë ose me një ose më shumë vende të tjera, përderisa ky vend ose organizatë ndërkombëtare ofron garanci të mjaftueshme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve.

4. Ky ligj nuk zbatohet për sistemet ose modelet IA, përfshirë rezultatet e tyre, të zhvilluara dhe vëna në shërbim posaçërisht për qëllimin e vetëm të kërkimit shkencor dhe zhvillimit.

5. Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë për mbrojtjen e të dhënave personale, privatësisë dhe konfidencialitetit të komunikimeve zbatohet për të dhënat personale të përpunuara në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë Ligj.

6. Ky ligj nuk zbatohet për ndonjë veprimtari kërkimi, testimi ose zhvillimi që ka të bëjë me sistemet ose modelet IA përpara se ato të hidhen në treg ose të vihen në shërbim. Këto veprimtari duhet të kryhen në përputhje me të drejtën e zbatueshme në Republikën e Shqipërisë. Testimi në kushte reale nuk përfshihet në këtë përjashtim.

7. Ky ligj nuk paragjykon rregullat e përcaktuara nga akte të tjera ligjore në Republikën e Shqipërisë që lidhen me mbrojtjen e konsumatorit dhe sigurinë e produkteve.

8. Ky ligj nuk zbatohet për detyrimet e përdoruesve që janë persona fizikë dhe që përdorin sisteme të IA-së në kuadër të një veprimtarie tërësisht personale dhe joprofessionale.

9. Ky ligj zbatohet pa cenuar dispozitat e legjislacionit të punës, legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe marrëveshjet kolektive, kur ato parashikojnë standarde më të favorshme për mbrojtjen e punëmarrësve në lidhje me përdorimin e sistemeve të IA-së nga punëdhënësit.

10. Ky ligj nuk zbatohet për sistemet e IA-së që lëshohen nën licenca të lira dhe me burim të hapur, përveç rasteve kur ato hidhen në treg ose vihen në shërbim si sisteme të IA-së me rrezik të lartë, ose si sisteme të IA-së që bien në fushën e zbatimit të nenit 5 të këtij ligji.

Neni 3 ***Përkufizimet***

Për qëllimet e këtij ligji, vlejné përkufizimet e mëposhtme:

1. “sistem IA” do të thotë një sistem i bazuar në makineri që është projektuar të funksionojë me nivele të ndryshme autonomie dhe që mund të shfaqë adaptueshmëri pas vendosjes në funksion, dhe që, për objektiva të shprehur ose të nënkuptuar, nxjerr, nga të dhënat hyrëse që merr, mënyrën për të gjeneruar rezultate si parashikime, përmbajtje, rekomandime ose vendime që mund të ndikojnë në mjedise fizike ose virtuale;
2. “rrezik” do të thotë kombinimi i probabilitetit të ndodhjes së dëmit dhe pasojave të atij dëmi;
3. “ofrues” do të thotë një person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose organ tjetër që zhvillon një sistem IA ose model të IA-së me qëllim të përgjithshëm ose që ka një sistem IA ose model të IA-së të zhvilluar dhe e hedh në treg ose e vë në shërbim nën emrin apo markën e vet, qoftë me pagesë apo falas;
4. “përdorues” do të thotë një person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose organ tjetër që përdor një sistem IA nën autoritetin e tij përveç rasteve kur sistemi i IA-së përdoret në kuadër të një aktiviteti thjesht personal joprofesional;
5. “përfaqësues i autorizuar” do të thotë një person fizik ose juridik i lokalizuar ose i vendosur në Republikën e Shqipërisë i cili ka marrë dhe pranuar një mandat me shkrim nga një ofrues i një sistemi i IA-së ose modeli IA me qëllim të përgjithshëm për të kryer detyrimet dhe procedurat sipas këtij ligjin në emër të tij;
6. “importues” do të thotë një person fizik ose juridik i vendosur në Republikën e Shqipërisë që hedh në treg një sistem IA që mban emrin ose markën tregtare të një subjekti të vendosur në një shtet tjetër;
7. “shpërndarës” do të thotë një person fizik ose juridik në zinxhirin e furnizimit, tjetër nga ofruesi ose importuesi, që e vë në dispozicion një sistem IA në tregun e Republikës së Shqipërisë;
8. “operator” do të thotë ofrues, prodhues i produktit, përdorues, përfaqësues i autorizuar, importues ose shpërndarës;
9. “hedhje në treg” do të thotë vënia për herë të parë në dispozicion e një sistemi i IA-së ose modeli IA me qëllim të përgjithshëm në tregun e Republikës së Shqipërisë;
10. “vënie në dispozicion në treg” do të thotë furnizimi i një sistemi i IA-së ose modeli IA me qëllim të përgjithshëm për shpërndarje ose përdorim në tregun e Republikës së Shqipërisë në kuadër të një veprimtarie tregtare, qoftë me pagesë ose falas;
11. “vënie në shërbim” do të thotë furnizimi i një sistemi i IA-së për përdorim të parë direkt tek përdoruesi ose për përdorim të vet në Republikën e Shqipërisë për qëllimin e parashikuar;
12. “qëllim i parashikuar” do të thotë përdorimi për të cilin një sistem IA është parashikuar nga ofruesi, përfshirë kontekstin dhe kushtet specifike të përdorimit, siç përcaktohen në

informacionin e dhënë nga ofruesi në udhëzimet për përdorim, materialet promovuese ose teknike;

13. “përdorim i parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme” do të thotë përdorimi i një sistemi të IA-së në kushte ose për qëllime që nuk janë të parashikuara nga ofruesi, por që mund të priten në mënyrë të arsyeshme si rezultat i sjelljes së parashikueshme njerëzore ose ndërveprimit me sisteme të tjera, përfshirë sisteme të tjera të IA-së.”
14. “komponent sigurie” do të thotë një komponent i një produkti ose sistemi i IA-së që përmbush një funksion sigurie për atë produkt ose sistem, ose dështimi ose mosfunksionimi i të cilit rrezikon shëndetin dhe sigurinë e njerëzve ose pronës;
15. “udhëzime për përdorim” do të thotë informacioni i dhënë nga ofruesi për të informuar përdoruesin, veçanërisht për qëllimin e parashikuar dhe përdorimin e duhur të sistemit IA;
16. “tërheqje e një sistemi i IA-së” do të thotë çdo masë që synon kthimin te ofruesi ose nxjerrjen jashtë funksioni ose ndalimin e përdorimit të një sistemi i IA-së të vënë në dispozicion të përdoruesve;
17. “tërheqje nga tregu e një sistemi i IA-së” do të thotë çdo masë që synon të parandalojë që një sistem IA në zinxhirin e furnizimit të vihet në dispozicion në treg;
18. “performanca e një sistemi i IA-së” do të thotë aftësia e një sistemi i IA-së për të arritur qëllimin e tij të parashikuar;
19. “autoritet njoftues” do të thotë autoriteti kombëtar përgjegjës për krijimin dhe zbatimin e procedurave për vlerësimin, emërimin dhe njoftimin e organeve të vlerësimit të konformitetit dhe për monitorimin e tyre;
20. “vlerësim i konformitetit” do të thotë procesi i demonstrimit nëse kërkesat e përcaktuara në Kapitullin III, Seksioni 2 për një sistem IA me rrezik të lartë janë përmbushur;
21. “organ vlerësimi i konformitetit” do të thotë një organ që kryen veprimtari vlerësimi të konformitetit të palës së tretë, përfshirë testimin, certifikimin dhe inspektimin;
22. “organ i njoftuar” do të thotë një organ vlerësimi i konformitetit i njoftuar në përputhje me këtë Ligj dhe legjislacionin përkatës të harmonizuar të Republikës së Shqipërisë;
23. “modifikim i rëndësishëm” do të thotë një ndryshim në një sistem IA pas hedhjes në treg ose vënies në shërbim, që nuk është parashikuar apo planifikuar në vlerësimin fillestar të konformitetit të kryer nga ofruesi dhe si rezultat i të cilit preket konformiteti me kërkesat e Kapitullit III, Seksioni 2, ose ndryshohet qëllimi për të cilin është vlerësuar sistemi;
24. “shenjë CE” do të thotë një shenjë me të cilën një ofrues tregon se një sistem IA është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kapitullin III, Seksioni 2 dhe në legjislacionin përkatës të harmonizuar në Republikën e Shqipërisë që parashikon vendosjen e saj;
25. “sistem monitorimi pas tregut” do të thotë të gjitha veprimtaritë e kryera nga ofruesit e sistemeve IA për të mbledhur dhe shqyrtuar përvojat e fituara nga përdorimi i sistemeve IA që ata hedhin në treg ose vënë në shërbim, për të identifikuar çdo nevojë për të marrë menjëherë masa korigjuese ose parandaluese;

26. “autoritet mbikëqyrjeje tregu” do të thotë autoriteti kombëtar përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve të mbikëqyrjes së tregut dhe marrjen e masave në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen e tregut në Republikën e Shqipërisë;
27. “standard i harmonizuar” standard i miratuar sipas legjislacionit në fuqi të adoptuar në Republikën e Shqipërisë;
28. “specifikim i përbashkët” do të thotë një grup specifikimesh teknike të miratuara nga autoritetet kompetente për të siguruar konformitetin me kërkesat e këtij ligji;
29. “të dhëna trajnuese” do të thotë të dhënat që përdoren për të trajnuar një sistem IA përmes përshtatjes së parametrave të tij që mund të mësohen;
30. “të dhëna për vlefshmëri” do të thotë të dhënat që përdoren për të vlerësuar një sistem IA të trajnuar dhe për të rregulluar parametrat e tij të pandryshueshëm dhe procesin e të mësuarit, ndër të tjera, për të parandaluar mbimësimin ose nënmësimin;
31. “grup të dhënash për vlefshmëri” do të thotë një grup i ndarë të dhënash ose pjesë e grupit të të dhënave trajnuese, qoftë si ndarje e fiksuar apo e ndryshueshme;
32. “të dhëna testuese” do të thotë të dhëna që përdoren për të bërë një vlerësim të pavarur të një sistemi i IA-së me qëllim konfirmimin e performancës së prititur të atij sistemi para se të hidhet në treg apo të vihet në shërbim;
33. “të dhëna hyrëse” do të thotë të dhëna që i jepen ose merren drejtpërdrejt nga një sistem IA mbi bazën e të cilave ai prodhon një rezultat;
34. “të dhëna biometrike” do të thotë të dhëna personale që rezultojnë nga përpunimi teknik specifik në lidhje me karakteristikat fizike, fiziologjike ose të sjelljes së një personi natyror, si për shembull imazhe të fytyrës ose të dhëna të gjurmëve të gishtërinjve;
35. “identifikim biometrik” do të thotë njohja automatike e karakteristikave njerëzore për qëllimin e përcaktimit të identitetit të një personi përmes krahasimit të të dhënave të tij biometrike me të dhënat e ruajtura në një bazë të dhënash;
36. “verifikim biometrik” do të thotë verifikimi një-për-një i identitetit të një personi në mënyrë automatike, përmes krahasimit të të dhënave të reja biometrike me ato të dhëna të dhëna më parë;
37. “kategori të veçanta të të dhënave personale” sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë
38. “të dhëna operationale të ndjeshme” do të thotë të dhëna që lidhen me aktivitetet e parandalimit, zbulimit, hetimit ose ndjekjes penale të veprave penale, zbulimi i të cilave mund të rrezikojë integritetin e procedurave penale;
39. “sistem njohjeje të emocioneve” do të thotë një sistem IA që ka për qëllim të identifikojë ose të nxjerrë emocione ose qëllime të personave në bazë të të dhënave të tyre biometrike;
40. “sistem kategorizimi biometrik” do të thotë një sistem IA që ka për qëllim të caktojë persona në kategori specifike në bazë të të dhënave të tyre biometrike, përveç kur kjo është e nevojshme për arsye teknike objektive dhe është pjesë ndihmëse e një shërbimi tjetër tregtar;

41. “sistem identifikimi biometrik në distancë” do të thotë një sistem IA që synon të identifikojë persona pa pjesëmarrjen aktive të tyre, zakonisht nga distanca, përmes krahasimit të të dhënave të tyre biometrike me ato të ruajtura në një bazë të dhënash referuese;
42. “sistem identifikimi biometrik në kohë reale” do të thotë një sistem i tillë ku mbledhja, krahasimi dhe identifikimi ndodhin pa vonesë të konsiderueshme, përfshirë identifikimin e menjëhershëm ose me vonesë shumë të kufizuar;
43. “sistem pas-identifikimi biometrik në distancë” do të thotë një sistem i tillë që nuk funksionon në kohë reale;
44. “hapësirë publike e lejuar” do të thotë çdo vend fizik, publik ose privat, ku një numër i pacaktuar personash ka akses, pavarësisht nëse aplikohen kushte për hyrje apo kufizime kapaciteti;
45. “autoritet i zbatimit të ligjit” do të thotë çdo autoritet publik kompetent për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen penale të veprave penale ose për ekzekutimin e sanksioneve penale, përfshirë mbrojtjen kundër kërcënimeve ndaj sigurisë publike dhe parandalimin e tyre.
46. “organ i zbatimit të ligjit” do të thotë çdo organ ose njësi që vepron në emër të një autoriteti të zbatimit të ligjit në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.
47. “Struktura IA-së” do të thotë funksioni i Autoritetit që ka për detyrë zbatimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve IA dhe modeleve IA me qëllim të përgjithshëm
48. “autoritet kompetent” do të thotë autoriteti njoftues, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, AKSHI si autoritet koordinues/Strukturë për IA-në, si dhe çdo autoritet tjetër i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për zbatimin e këtij ligji;
49. “incident serioz” do të thotë incident ose defekt i një sistemi i IA-së që çon drejtpërdrejt ose tërthorazi në ndonjërin nga pasojat e mëposhtme:
 - (a) vdekja ose dëmtim serioz i shëndetit të një personi;
 - (b) ndërprerje serioze dhe e pakthyeshme e menaxhimit të infrastrukturës kritike;
 - (c) shkelje të të drejtave themelore sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë;
 - (d) dëmtim serioz i pronës ose mjedisit;
50. “të dhëna personale” sipas legjislacionit në fuqi për të dhënat personale
51. “të dhëna jopersonale” sipas legjislacionit në fuqi për të dhënat personale;
52. “mjedis testimi” do të thotë një mjedis i kontrolluar për zhvillimin, testimin dhe validimin e sistemeve të IA-së përpara vënies së tyre në treg ose në shërbim.
53. “plan testimi në kushte reale” do të thotë një dokument që përshkruan objektivat, metodologjinë, përfshirjen gjeografike, popullsinë dhe kohën, si dhe mënyrën e monitorimit dhe organizimit të testimit jashtë mjediseve laboratorike;
54. “plan sandbox-i” do të thotë një dokument i rënë dakord mes ofruesit dhe autoritetit kompetent që përshkruan objektivat, kushtet, afatet dhe metodologjinë e testeve brenda një kuadri të mbikëqyrur rregullator (sandbox);

55. “sandbox rregullator për IA” do të thotë një kuadër i kontrolluar i ngritur nga një autoritet kompetent që u ofron ofruesve të mundshëm të IA-së mundësinë për të zhvilluar, trajnuar dhe testuar një sistem inovativ IA për një kohë të kufizuar nën mbikëqyrje;
56. “aftësi në IA (IA literacy)” do të thotë njohuritë dhe aftësitë që u mundësojnë ofruesve, përdoruesve dhe personave të prekur të kuptojnë, përdorin dhe vlerësojnë teknologjitë IA në mënyrë të informuar;
57. “testim në kushte reale” do të thotë testimi i përkohshëm i një sistemi i IA-së për qëllimin e tij të synuar jashtë një mjedisi të simuluar, për të mbledhur të dhëna të besueshme dhe për të verifikuar konformitetin me kërkesat e rregullores, për sa kohë plotësohen kushtet e nenit 60 të këtij ligji;
58. “subjekt” do të thotë një person natyror që merr pjesë në testim në kushte reale;
59. “pëlqim i informuar” do të thotë shprehje e qartë, specifike, vullnetare dhe e vetëdijshme e dëshirës për të marrë pjesë në një testim të tillë;
60. “deep fake” do të thotë përmbajtje e krijuar ose manipuluar nga IA që ngjan me persona, objekte ose ngjarje ekzistuese dhe që i paraqitet një personi si autentike ose e vërtetë;
61. “përmbajtje sintetike” do të thotë përmbajtje audio, imazh, video ose tekst e krijuar ose e manipuluar artificialisht nga një sistem IA.
62. “infrastrukturë kritike” ka kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij;
63. “model të IA-së me qëllim të përgjithshëm” do të thotë një model të IA-së, përfshirë ato të trajnuar me shumë të dhëna përmes vetë-mësimit, që shfaq kompetencë për shumë detyra të ndryshme dhe mund të integrohet në sisteme të tjera IA, përveç modeleve të përdorura vetëm për kërkim ose prototipim;
64. “aftësi me ndikim të lartë” do të thotë aftësi që përputhen ose i tejkalojnë ato të modeleve më të avancuara të IA-së me qëllim të përgjithshëm;
65. “rrezik sistemik” do të thotë rrezik i lidhur me aftësitë me ndikim të lartë të modeleve të IA-së që ka ndikim të konsiderueshëm në tregun e Shqipërisë ose në shëndetësinë publike, sigurinë, të drejtat themelore ose shoqërinë;
66. “sistem IA me qëllim të përgjithshëm” do të thotë sistem IA i bazuar në një model të tillë që mund të përdoret drejtpërdrejt ose të integrohet në sisteme të tjera IA;
67. “operacion me presje dhjetore (floating-point operation)” do të thotë çdo operacion matematikor me numra realë të përfaqësuar në kompjuter me precizion të caktuar;
68. “ofrues në zinxhirin e poshtëm (downstream provider)” do të thotë ofruesi i një sistemi i IA-së që integron një model të IA-së, qoftë i zhvilluar vetë ose i ofruar nga një palë tjetër.

Neni 4

Aftësim në IA

1. Ofruesit dhe përdoruesit e sistemeve të IA duhet të marrin masa për të siguruar, sa më mirë që të mundin, një nivel të mjaftueshëm të aftësisë në IA për stafin e tyre dhe personat e tjerë që merren

me operimin dhe përdorimin e sistemeve të IA në emër të tyre, duke marrë parasysh njohuritë teknike, përvojën, arsimin dhe trajnimet e tyre, si dhe kontekstin ku do të përdoren sistemet e IA, dhe duke konsideruar personat ose grupet e personave mbi të cilët do të përdoren sistemet e IA.

KREU II

PRAKTIKAT E NDALUARA TË IA-së

Neni 5

Praktikat e ndaluara të IA-së

1. Praktikat e mëposhtme të IA-së do të ndalohen:

- (a) Vënia në treg, vënia në përdorim ose përdorimi i një sistemi i IA-së që përdor teknika të pavullnetshme përtej ndërgjegjes së një personi ose teknika që janë qëllimisht manipulues ose mashtruese, me objektivin ose efektin e shtrembërimit të rëndësishëm të sjelljes së një personi ose grupi personash duke dëmtuar ndjeshëm aftësinë e tyre për të marrë një vendim të informuar, duke i bërë ata të marrin një vendim që normalisht nuk do ta merrnin, në mënyrë që të shkaktojë ose të jetë me shumë mundësi që të shkaktojë dëm të rëndësishëm për atë person, një person tjetër ose një grup personash;
- (b) Vënia në treg, vënia në përdorim ose përdorimi i një sistemi i IA-së që shfrytëzon ndonjë nga dobësitë e një personi fizik ose një grupi të caktuar personash për shkak të moshës, aftësisë së kufizuar ose situatës së tyre sociale ose ekonomike, me objektivin ose efektin e shtrembërimit të rëndësishëm të sjelljes së atij personi ose personave në atë grup në mënyrë që të shkaktojë ose të jetë me shumë mundësi që të shkaktojë dëm të rëndësishëm për atë person ose një person tjetër;
- (c) Vënia në treg, vënia në përdorim ose përdorimi i sistemeve IA për vlerësimin ose klasifikimin e personave fizikë ose grupeve të personave gjatë një periudhe të caktuar kohore bazuar në sjelljen e tyre sociale ose karakteristikat personale ose të personalitetit të njohura, të nxjerra në përfundim ose të parashikuara, me rezultat të një vlerësimi social që çon në një trajtim të dëmshëm ose të pafavorshëm të disa personave fizikë ose grupeve të tyre në kontekste shoqërore që nuk lidhen me kontekstet ku janë gjeneruar ose mbledhur të dhënat;
- (d) Vënia në treg, vënia në përdorim ose përdorimi i një sistemi i IA-së për vlerësimin e rrezikut të personave fizikë për të vlerësuar ose parashikuar rrezikun që një person të kryejë një veprë penale, bazuar vetëm në profilizimin e personit fizik ose në vlerësimin e karakteristikave dhe tipareve të personalitetit të tij; kjo ndalim nuk zbatohet për sistemet e IA-së që përdoren për të mbështetur vlerësimin njerëzor të përfshirjes së një personi në një aktivitet kriminal, i cili është tashmë bazuar në fakte objektive dhe të verifikueshme të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetin kriminal;
- (e) Vënia në treg, vënia në përdorim ose përdorimi i sistemeve IA që krijojnë ose zgjerojnë bazat e të dhënave të njohjes së fytyrës përmes mbledhjes së pafokusuar të imazheve të fytyrës nga interneti ose regjistrimet e kamerave të sigurisë;

- (f) Vënia në treg, vënia në përdorim ose përdorimi i sistemeve IA për të nxjerrë në përfundim emocionet e një personi fizik në vendet e punës dhe institucionet arsimore, përveç rasteve kur përdorimi i sistemit IA është për qëllime mjekësore ose sigurie;
- (g) Vënia në treg, vënia në përdorim ose përdorimi i sistemeve të kategorizimit biometrik që kategorizojnë personat fizikë individualisht bazuar në të dhënat e tyre biometrike për të nxjerrë në përfundim racën, opinionet politike, anëtarësinë në sindikatë, besimet fetare ose filozofike, jetën seksuale ose orientimin seksual; ky ndalim nuk përfshin etiketimin ose filtrimin e grupeve biometrike të fituara ligjërisht, si imazhet, bazuar në të dhëna biometrike ose kategorizimin e të dhënave biometrike në fushën e zbatimit të ligjit;
- (h) Përdorimi i sistemeve të identifikimit biometrik “në kohë reale” në hapësira publike për qëllime të zbatimit të ligjit, përveç në rastet kur përdorimi është domosdoshmërisht i nevojshëm për një nga objektivat e mëposhtme:
 - (i) Kërkimi i synuar për viktima të rrëmbimit, trafikimit të qenieve njerëzore ose shfrytëzimit seksual, si dhe kërkimi i personave të zhdukur;
 - (ii) Parandalimi i një kërcënimi specifik, të konsiderueshëm dhe të menjëhershëm për jetën ose sigurinë fizike të personave fizikë ose një kërcënimi të vërtetë dhe të pranishëm ose të parashikueshëm për një sulm terrorist;
 - (iii) Lokalizimi ose identifikimi i një personi të dyshuar për kryerjen e një vepre penale, për qëllimin e hetimit penal, ndjekjes penale ose ekzekutimit të një dënimi për veprat penale të përmendura në Aneksin II të këtij ligji, të ndëshkueshme me burgim ose masa të tjera të detentimit për një periudhë minimale prej katër vjetësh.

2. Përdorimi i sistemeve të identifikimit biometrik “në kohë reale” në hapësira publike duhet të përdoret vetëm për konfirmimin e identitetit të individit të synuar dhe duhet të marrë parasysh elementet e mëposhtme:

- (a) Natyrën e situatës që mund të justifikojë përdorimin, në veçanti seriozitetin, probabilitetin dhe shkallën e dëmit që do të shkaktohej nëse sistemi nuk do të përdorej;
- (b) Pasojat e përdorimit të sistemit për të drejtat dhe liritë e të gjitha personave të përfshirë, duke vlerësuar seriozitetin, probabilitetin dhe shkallën e këtyre pasojave.

3. Përdorimi i sistemeve të identifikimit biometrik “në kohë reale” në hapësira publike për qëllime të zbatimit të ligjit autorizohet vetëm në kushtet, kufizimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë ligj, në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në legjislacionin procedural penal, veçanërisht lidhur me kufizimet kohore, gjeografike dhe personale. Përdorimi lejohet vetëm pasi autoriteti përgjegjës për zbatimin e ligjit ka kryer vlerësimin e ndikimit në të drejtat themelore sipas nenit 42 të këtij ligji dhe ka regjistruar sistemin në regjistrin kombëtar të sistemeve të IA-së sipas nenit 49 të këtij ligji. Në raste emergjente, përdorimi mund të fillojë pa regjistrim paraprak, por regjistrimi kryhet pa vonesë të panevojshme.

4. Për qëllimet e pikës 1, shkronja “h”, dhe të pikës 2 të këtij neni, përdorimi i sistemeve të identifikimit biometrik “në kohë reale” në hapësira publike për qëllime të zbatimit të ligjit lejohet vetëm me autorizim paraprak të gjykatës kompetente, mbi bazën e kërkesës së arsyetuar të autoritetit përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe në përputhje me këtë ligj, Kodin e Procedurës Penale

dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Në raste emergjente, përdorimi mund të nisë pa autorizim paraprak, me kusht që kërkesa për autorizim të paraqitet brenda 24 orëve. Nëse autorizimi refuzohet, përdorimi ndërpritet menjëherë dhe të dhënat dhe rezultatet e përfuara fshihen, përveç kur ruajtja e tyre kërkohet nga legjislacioni procedural penal.

5. Autoriteti kompetent do të japë autorizimin vetëm nëse është i bindur, bazuar në prova objektive ose indikacione të qarta, se përdorimi është i nevojshëm dhe proporcional për arritjen e njërit nga qëllimet e përmendura në paragraf 1 pika (h), dhe se përdorimi mbetet i kufizuar në periudhën kohore, zonën gjeografike dhe personat e përfshirë. Nuk mund të merret asnjë vendim me efekt negativ ligjor për një person vetëm bazuar në rezultatin e sistemit të identifikimit biometrik në kohë reale.

6. Pa cenuar pikën 3 të këtij neni, çdo përdorim i këtyre sistemeve për qëllime të zbatimit të ligjit njoftohet te autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut dhe te Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Njoftimi përmban informacionin e nevojshëm për qëllimin, kohëzgjatjen, bazën ligjore, zonën gjeografike, kategorinë e personave të përfshirë dhe masat mbrojtëse, pa përfshirë të dhëna operationale të ndjeshme.

7. Rregullat e hollësishme për kërkesën, dhënien, përdorimin, mbikëqyrjen, dokumentimin dhe raportimin e autorizimeve për përdorimin e sistemeve të identifikimit biometrik “në kohë reale” në hapësira publike për qëllime të zbatimit të ligjit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me kufizimet dhe kushtet e parashikuara në këtë nen.

Kreu III

SISTEMET IA ME RREZIK TË LARTË

Seksioni 1

Klasifikimi i sistemeve IA si me rrezik të lartë

Neni 6

Rregullat e klasifikimit për sistemet e IA-së me rrezik të lartë

1. Pavarësisht nëse një sistem IA vendoset në treg ose vihet në shërbim në mënyrë të pavarur nga produktet e përmendura në pikat (a) dhe (b), ai sistem IA do të konsiderohet me rrezik të lartë kur plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

(a) sistemi i IA-së është i destinuar të përdoret si një komponent sigurie i një produkti, ose sistemi i IA-së vetë është një produkt, i mbuluar nga legjislacioni i harmonizuar i Republikës së Shqipërisë të përmendur në Aneksin I të këtij ligji;

(b) produkti për të cilin komponent sigurie sipas pikës (a) është sistemi i IA-së, ose sistemi i IA-së vetë si produkt, është i detyruar të kalojë një vlerësim të konformitetit nga një palë e tretë, me qëllim vendosjen në treg ose vënien në shërbim të atij produkti sipas legjislacionit të harmonizuar në Republikës së Shqipërisë të përmendur në Aneksin I të këtij ligji.

2. Përveç sistemeve IA me rrezik të lartë të përmendura në pika 1, sistemet e IA-së të përmendura në Aneksin III të këtij ligji do të konsiderohen gjithashtu me rrezik të lartë.

3. Me përjashtim nga pika 2, një sistem IA i përmendur në Aneksin III të këtij ligji nuk do të konsiderohet me rrezik të lartë nëse nuk paraqet një rrezik të konsiderueshëm për shëndetin, sigurinë ose të drejtat themelore të personave fizikë, përfshirë edhe nëse nuk ndikon në mënyrë të konsiderueshme në rezultatin e marrjes së vendimeve.

4. Pika 3 e këtij neni zbatohet kur plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

- (a) sistemi i IA-së është i destinuar të kryejë një detyrë procedurale të kufizuar;
- (b) sistemi i IA-së është i destinuar të përmirësojë rezultatin e një veprimtarie njerëzore të përfunduar më parë;
- (c) sistemi i IA-së është i destinuar të zbulojë modelet e marrjes së vendimeve ose devijimet nga modelet e mëparshme të marrjes së vendimeve dhe nuk ka për qëllim të zëvendësojë ose të ndikojë në vlerësimin e kryer nga një njeri më parë, pa rishikim të duhur njerëzor; ose
- (d) sistemi i IA-së është i destinuar të kryejë një detyrë përgatitore për një vlerësim që ka rëndësi për qëllimet e rasteve të përdorimit të përmendura në Aneksin III të këtij ligji.

5. Pavarësisht nga pika 3 e këtij neni, një sistem IA i përmendur në Aneksin III të këtij ligji konsiderohet gjithmonë me rrezik të lartë kur kryen profilizimin e personave fizikë.

6. Ofruesi që konsideron se një sistem IA i përmendur në Aneksin III të këtij ligji nuk është me rrezik të lartë duhet të dokumentojë vlerësimin e tij para se sistemi të vendoset në treg ose të vihet në shërbim. Ky ofrues do të jetë subjekt i detyrimit të regjistrimit të përmendur në nenin 49 të këtij ligji. Sipas kërkesës së autoriteteve kompetente kombëtare, ofruesi duhet të sigurojë dokumentacionin e vlerësimit.

7. Autoritetet kompetente për zbatimin e këtij ligji, përgjegjësitë, detyrat, mënyra e bashkëpunimit dhe funksionimi i tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me nenet 28–30, 45–49 dhe 72 të këtij ligji për Autoritetin njoftues, Autoritetin e mbikëqyrjes së tregut, AKSHI-n si Strukturë për IA-në dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 7

Ndryshimet në Aneksin III të këtij ligji

1. Këshilli i Ministrave ka fuqinë të miratojë akte nënligjore në përputhje me nenin 103 të këtij ligji për të ndryshuar Aneksin III të këtij ligji duke shtuar ose modifikuar rastet e përdorimit të sistemeve IA me rrezik të lartë, kur plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

- (a) sistemet e IA-së janë të destinuara për t'u përdorur në çdo nga fushat e përmendura në Aneksin III të këtij ligji;
- (b) sistemet e IA-së paraqesin një rrezik për shëndetin dhe sigurinë, ose ndikim negativ në të drejtat themelore, dhe ky rrezik është i barabartë ose më i madh se rreziku i dëmshëm ose ndikimi negativ i shkaktuar nga sistemet e IA-së me rrezik të lartë që tashmë përmenden në Aneksin III të këtij ligji.

2. Kur vlerëson kushtin e parashikuar në pika 1, pika (b), autoritetet kompetente duhet të marrin parasysh kriteret e mëposhtme:

- (a) qëllimi i synuar i sistemit IA;
 - (b) shkalla në të cilën një sistem IA është përdorur ose ka gjasa të përdoret;
 - (c) natyra dhe sasia e të dhënave të përpunuara dhe të përdorura nga sistemi i IA-së, veçanërisht nëse përpunohen kategori të veçanta të të dhënave personale;
 - (d) shkalla në të cilën sistemi i IA-së vepron në mënyrë autonome dhe mundësia që një njeri të anulohet një vendim ose rekomandim që mund të shkaktojë dëm potencial;
 - (e) shkalla në të cilën përdorimi i një sistemi i IA-së ka shkaktuar dëme për shëndetin dhe sigurinë, ka pasur ndikim negativ në të drejtat themelore ose ka ngritur shqetësime të rëndësishme lidhur me mundësinë e këtij dëmi ose ndikimi negativ, siç tregohet, për shembull, nga raporte ose akuza të dokumentuara të paraqitura tek autoritetet kompetente ose nga raporte të tjera, sipas rastit;
 - (f) shkalla e mundshme e këtij dëmi ose ndikimi negativ, veçanërisht në aspektin e intensitetit dhe aftësisë për të prekur shumë persona ose për të ndikuar në mënyrë disproporcionale një grup të caktuar personash;
 - (g) shkalla në të cilën personat që potencialisht dëmtohen ose vuajnë një ndikim negativ janë të varur nga rezultati i prodhuar nga sistemi i IA-së, veçanërisht sepse për arsye praktike ose ligjore nuk është e mundur të shmangen nga ky rezultat;
 - (h) shkalla në të cilën ekziston një pabarazi pushteti, ose personat që potencialisht dëmtohen ose vuajnë një ndikim negativ janë në një pozicion të cenueshëm në lidhje me përdoruesin e sistemit IA, veçanërisht për shkak të statusit, autoritetit, njohurive, rrethanave ekonomike ose sociale, ose moshës;
 - (i) shkalla në të cilën rezultati i prodhuar nga sistemi i IA-së është lehtësisht i korigjueshëm ose i kthyeshëm, duke marrë parasysh zgjidhjet teknike të disponueshme për ta korigjuar ose kthyer atë, ku rezultatet që kanë ndikim negativ në shëndet, siguri ose të drejtat themelore nuk do të konsiderohen lehtësisht të korigjueshme ose të kthyeshme;
 - (j) madhësia dhe probabiliteti i përfitimit nga përdorimi i sistemit IA për individët, grupet, ose shoqërinë në përgjithësi, përfshirë përmirësimet e mundshme në sigurinë e produktit;
 - (k) shkalla në të cilën ligji ekzistues i Republikës së Shqipërisë siguron:
 - (i) masa efektive kompensimi në lidhje me rreziqet që sjell një sistem IA, me përjashtim të kërkesave për dëmtime;
 - (ii) masa efektive për parandalimin ose minimizimin e këtyre rreziqeve.
3. Këshilli i Ministrave ka fuqinë të miratojë akte nënligjore në përputhje me nenin 103 të këtij ligji për të ndryshuar listën në Aneksin III të këtij ligji duke hequr sistemet e IA-së me rrezik të lartë kur plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:
- (a) sistemi i IA-së me rrezik të lartë i përmendur nuk paraqet më asnjë rrezik të konsiderueshëm për të drejtat themelore, shëndetin ose sigurinë, duke marrë parasysh kriteret e listuara në pika 2;
 - (b) heqja nuk ul nivelin e përgjithshëm të mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe të drejtave themelore sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

SEKSIONI 2

Kërkesat për sistemet e IA-së me rrezikshmëri të lartë

Neni 8

Përputhshmëria me kërkesat

1. Sistemet IA me rrezik të lartë duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë Seksion, duke marrë parasysh qëllimin e tyre të synuar si dhe nivelin e njohur dhe të pranuar të zhvillimit në fushën e IA dhe teknologjive të lidhura me IA. Sistemi i menaxhimit të rrezikut, i përmendur në nenin 9 të këtij ligji, duhet të merret në konsideratë gjatë sigurimit të konformitetit me këto kërkesa.

2. Kur një produkt përmban një sistem IA, për të cilin zbatohen kërkesat e këtij ligji si dhe kërkesat e legjislacionit të harmonizuar në Republikës së Shqipërisë të listuar në Seksionin A të Aneksit I të këtij ligji, ofruesit janë përgjegjës për sigurimin që produkti i tyre të jetë plotësisht në përputhje me të gjitha kërkesat e zbatueshme sipas legjislacionit të harmonizuar të Republikës së Shqipërisë. Për të siguruar konformitetin e sistemeve IA me rrezik të lartë të përmendura në pika 1 me kërkesat e këtij Seksioni, dhe për të siguruar qëndrueshmëri, shmangie të dyfishtë dhe minimizim të barrëve shtesë, ofruesit kanë mundësinë të integrojnë, sipas rastit, proceset e nevojshme të testimit dhe raportimit, informacionin dhe dokumentacionin që ofrojnë për produktin e tyre në dokumentacionin dhe procedurat që tashmë ekzistojnë dhe kërkohen sipas legjislacionit të harmonizuar në Republikës së Shqipërisë të listuar në Seksionin A të Aneksit I të këtij ligji.

3. Zbatimi i kërkesave bëhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe nivelin e rrezikut

Neni 9

Sistemi i menaxhimit të rrezikut

1. Për menaxhimin e rrezikut në lidhje me sistemet e IA-së me rrezik të lartë krijohet, zbatohet, dokumentohet dhe mirëmbahet sistemi i menaxhimit të rrezikut. Rregullat e hollësishtme për funksionimin dhe dokumentimin e këtij sistemi miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Sistemi i menaxhimit të rrezikut kuptohet si një proces i vazhdueshëm dhe iterativ, i planifikuar dhe i kryer gjatë gjithë ciklit të jetës së sistemit IA me rrezik të lartë, që kërkon rishikim dhe përditësim sistematik dhe të rregullt. Ai përfshin hapat e mëposhtëm:

- (a) identifikimi dhe analiza e rreziqeve të njohura dhe të arsyeshëm të parashikueshme që sistemi i IA-së me rrezik të lartë mund të shkaktojë ndaj shëndetit, sigurisë ose të drejtave themelore kur përdoret në përputhje me qëllimin e tij të synuar;
- (b) vlerësimi dhe estimimi i rreziqeve që mund të lindin kur sistemi i IA-së përdoret sipas qëllimit të tij dhe në kushtet e keqpërdorimit të arsyeshëm të parashikueshëm;
- (c) vlerësimi i rreziqeve të tjera që mund të lindin, bazuar në analizën e të dhënave të mbledhura nga sistemi i monitorimit pas-mbikqyrjes, i përmendur në nenin 72 të këtij ligji;
- (d) marrja e masave të përshtatshme dhe të synuara për menaxhimin e rrezikut që adresojnë rreziqet e identifikuara sipas pikës (a).

3. Rreziqet e përmendura në këtë Nen duhet të përfshijnë vetëm ato që mund të minimizohen ose eliminohen në mënyrë të arsyeshme përmes zhvillimit ose dizajnit të sistemit IA me rrezik të lartë, ose përmes sigurimit të informacionit teknik adekuat.
4. Masat e menaxhimit të rrezikut të përmendura në pika 2, pika (d), duhet të marrin në konsideratë efektet dhe ndërveprimet që mund të lindin nga zbatimi i përbashkët i kërkesave të këtij Seksioni, me qëllim minimizimin më efektiv të rreziqeve dhe arritjen e një bilanci të përshtatshëm në zbatimin e masave për përmbushjen e këtyre kërkesave.
5. Masat e menaxhimit të rrezikut duhet të jenë të tilla që rreziku mbetur përkatës i lidhur me çdo rrezik, si dhe rreziku i përgjithshëm i sistemeve IA me rrezik të lartë të konsiderohet i pranueshëm.
6. Në identifikimin e masave më të përshtatshme të menaxhimit të rrezikut, duhet të sigurohet:
 - (a) eliminimi ose zvogëlimi i rreziqeve të identifikuara dhe të vlerësuara sipas pika 2 përmes dizajnit dhe zhvillimit të përshtatshëm të sistemit IA, sa më shumë që të jetë teknikisht e mundur;
 - (b) kur është e përshtatshme, zbatimi i masave të mjaftueshme të zbutjes dhe kontrollit për rreziqet që nuk mund të eliminohen;
 - (c) sigurimi i informacionit të kërkuar sipas nenit 13 të këtij ligji dhe, kur është e përshtatshme, trajnimi për përdoruesit.
7. Duke pasur për synim eliminimin ose zvogëlimin e rreziqeve që lidhen me përdorimin e sistemit IA me rrezik të lartë, duhet të merret në konsideratë njohuria teknike, përvoja, arsimi, trajnimi që pritet të ketë përdoruesi, si dhe konteksti i supozuar i përdorimit të sistemit.
8. Sistemet IA me rrezik të lartë duhet të testohen për qëllim identifikimi të masave më të përshtatshme dhe të synuara për menaxhimin e rrezikut. Testimi duhet të sigurojë që këto sisteme performojnë në mënyrë të qëndrueshme për qëllimin e tyre dhe që janë në përputhje me kërkesat e këtij Seksioni.
9. Procedurat e testimit mund të përfshijnë testim në kushte reale në përputhje me nenin 60 të këtij ligji.
10. Testimi i sistemeve IA me rrezik të lartë duhet të kryhet, sipas rastit, gjatë gjithë procesit të zhvillimit dhe në çdo rast para se ato të vendosen në treg ose të përdoren. Testimi duhet të kryhet kundrejt matjeve dhe pragjeve probabilitike të përcaktuara më parë, të përshtatshme për qëllimin e synuar të sistemit IA.
11. Kur zbatohet sistemi i menaxhimit të rrezikut siç parashikohet në paragrafët 1 deri 7, ofruesit duhet të marrin në konsideratë nëse, duke pasur parasysh qëllimin e synuar, sistemi i IA-së me rrezik të lartë mund të ketë ndikim negativ në persona nën moshën 18 vjeç, dhe, kur është e përshtatshme, në grupe të tjera të cenueshme.
12. Për ofruesit e sistemeve IA me rrezik të lartë që janë subjekt i kërkesave për proceset e brendshme të menaxhimit të rrezikut sipas dispozitave të tjera të ligjit të Republikës së Shqipërisë, aspektet e parashikuara në paragrafët 1 deri 9 mund të jenë pjesë ose të kombinohen me procedurat e menaxhimit të rrezikut të vendosura sipas atij ligji.

Neni 10

Të dhënat dhe qeverisja e të dhënave

1. Sistemet IA me rrezik të lartë që përdorin teknika që përfshijnë trajnim të modeleve IA me të dhëna, duhet të zhvillohen bazuar në grupe të dhënash për trajnim, verifikim dhe testim që plotësojnë kriteret e cilësisë të përmendura në paragrafët 2 deri 5 sa herë që përdoren të tilla grupe të dhënash.

2. Grupet e të dhënave për trajnim, verifikim dhe testim duhet të jenë subjekt i praktikave të qeverisjes dhe menaxhimit të të dhënave që janë të përshtatshme për qëllimin e synuar të sistemit IA me rrezik të lartë. Këto praktika përfshijnë, veçanërisht:

- (a) zgjedhjet përkatëse të dizajnit;
- (b) proceset e mbledhjes së të dhënave dhe origjinën e tyre, dhe në rastin e të dhënave personale, qëllimin origjinal të mbledhjes së tyre;
- (c) operacionet përgatitore të të dhënave, si anotimi, etiketimi, pastrimi, përditësimi, pasurimi dhe agregimi;
- (d) formulimin e supozimeve, veçanërisht në lidhje me informacionin që të dhënat synojnë të matin dhe përfaqësojnë;
- (e) vlerësimin e disponueshmërisë, sasisë dhe përshtatshmërisë së grupeve të të dhënave të nevojshme;
- (f) ekzaminimin për mundësi paragjykimesh që mund të ndikojnë në shëndetin dhe sigurinë e personave, të kenë ndikim negativ në të drejtat themelore ose të çojnë në diskriminim të ndaluar nga ligji, veçanërisht kur rezultatet e të dhënave ndikojnë në të dhënat hyrëse për operacionet e ardhshme;
- (g) masat e përshtatshme për të zbuluar, parandaluar dhe zbutur paragjykimet e mundshme të identifikuar sipas pikës (f);
- (h) identifikimin e mungesave ose dobësive përkatëse në të dhëna që pengojnë konformitetin me këtë Ligj dhe mënyrën se si ato mund të adresohen.

3. Grupet e të dhënave për trajnim, verifikim dhe testim duhet të jenë të rëndësishme, mjaftueshëm përfaqësuese, dhe sa më shumë të jetë e mundur, pa gabime dhe të plota në lidhje me qëllimin e synuar. Ato duhet të kenë vetitë statistikore të përshtatshme, duke përfshirë, kur është e aplikueshme, ato që lidhen me personat apo grupet e personave për të cilët sistemi i IA-së me rrezik të lartë është synuar. Këto karakteristika mund të plotësohen në nivelin e grupeve individuale të të dhënave ose në nivelin e një kombinimi të tyre.

4. Grupet e të dhënave duhet të marrin parasysh, në masën që kërkohet nga qëllimi i synuar, karakteristikat ose elementët që janë të veçantë për kontekstin gjeografik, kontekstual, sjellësor ose funksional ku sistemi i IA-së me rrezik të lartë do të përdoret.

5. Në masën që është absolutisht e nevojshme për qëllimin e zbulimit dhe korrigjimit të paragjykimeve lidhur me sistemet e IA-së me rrezik të lartë sipas pikës 2, pikave (f) dhe (g), ofruesit e këtyre sistemeve mund të përpunojnë në mënyrë përjashtuese kategori speciale të të dhënave

personale, duke u nënshtruar masave të përshtatshme për të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë dhe duhet të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme që ky përpunim të kryhet:

- (a) zbulimi dhe korigjimi i paragjykimeve nuk mund të realizohet në mënyrë efektive duke përpunuar të dhëna të tjera, duke përfshirë të dhënat sintetike ose anonimizuar;
 - (b) kategoritë speciale të të dhënave personale janë subjekt i kufizimeve teknike për ri-përdorimin e tyre, dhe masave më të avancuara për sigurinë dhe privatësinë, duke përfshirë pseudonimizimin;
 - (c) kategoritë speciale të të dhënave personale janë subjekt i masave që sigurojnë që këto të dhëna të jenë të sigurta, të mbrojtura, me masa të përshtatshme mbrojtëse, duke përfshirë kontroll strikt dhe dokumentim të aksesit, për të parandaluar keqpërdorimin dhe për të siguruar që vetëm personat e autorizuar kanë akses, me detyrime të përshtatshme konfidencialiteti;
 - (d) kategoritë speciale të të dhënave personale nuk do të transmetohen, transferohen ose nuk do të aksesohen nga palë të tjera;
 - (e) kategoritë speciale të të dhënave personale fshihen sapo paragjykimi të jetë korigjuar ose sapo të dhënat të arrijnë fundin e periudhës së ruajtjes, çfarëdo të ndodhë më parë;
6. Për zhvillimin e sistemeve IA me rrezik të lartë që nuk përdorin teknika që përfshijnë trajnim të modeleve IA, paragrafët 2 deri 5 zbatohen vetëm për grupet e të dhënave të testimit.
 - (h) kur testimi organizohet në bashkëpunim me një ose më shumë përdorues ose përdorues të mundshëm, këta të fundit janë informuar për të gjitha aspektet e rëndësishme të testimit dhe kanë marrë udhëzimet për përdorimin e sistemit sipas nenit 13 të këtij ligji; palët duhet të lidhin një marrëveshje që përcakton rolet dhe përgjegjësitë për respektimin e këtij ligjidhe/ose të ligjit tjetër përkatës të Republikës së Shqipërisë;
 - (i) subjektet e testimit kanë dhënë pëlqimin e informuar në përputhje me nenin 61 të këtij ligji, ose, në rastin e zbatimit të ligjit, kur kërkimi i pëlqimit të informuar do të pengonte testimin, testimi dhe rezultatet e tij nuk duhet të kenë asnjë ndikim negativ mbi subjektet, dhe të dhënat e tyre personale duhet të fshihen pas përfundimit të testimit;
 - (j) testimi në kushte reale është i mbikëqyrur në mënyrë efektive nga ofruesi dhe përdoruesit përmes personave të kualifikuar dhe të trajnuar në fushën përkatëse, që kanë kapacitetin dhe autoritetin e nevojshëm;
 - (k) parashikimet, rekomandimet ose vendimet e sistemit të IA-së mund të kthehen pas dhe të injorohen në mënyrë efektive.
7. Çdo subjekt i testimit ose përfaqësuesi i tij ligjor, sipas rastit, mund të tërhiqet nga testimi në çdo kohë, pa pasoja negative dhe pa qenë i detyruar të japë ndonjë arsye, duke revokuar pëlqimin e informuar dhe mund të kërkojë fshirjen e menjëhershme dhe të përhershme të të dhënave të tij personale. Tërheqja e pëlqimit nuk ndikon në aktivitetet që janë kryer deri në atë moment.
8. Në përputhje me nenin 75 të këtij ligji, Këshilli i Ministrave do t'u japin autoriteteve të tyre të mbikëqyrjes së tregut kompetencat për të kërkuar informacion nga ofruesit dhe ofruesit e mundshëm, për të kryer inspektime të papritura në distancë ose në terren, dhe për të kontrolluar mënyrën e kryerjes së testimit dhe sistemet e IA-së përkatëse me rrezik të lartë. Këto autoritete do t'i përdorin kompetencat për të siguruar zhvillim të sigurt të testimeve në kushte reale.
9. Çdo incident serioz i identifikuar gjatë testimit në kushte reale duhet të raportohet te autoriteti kombëtar i mbikëqyrjes së tregut në përputhje me nenin 73 të këtij ligji. Ofruesi duhet të marrë masa të menjëhershme për zbutje të rrezikut ose, nëse kjo nuk është e mundur, të pezullojë ose

përfundojë testimin. Ai duhet të vendosë një procedurë për tërheqjen e shpejtë të sistemit të IA-së në rast përfundimi të testimit.

10. Ofruesit ose ofruesit e mundshëm duhet të njoftojnë autoritetin kombëtar të mbikëqyrjes së tregut për pezullimin ose përfundimin e testimit si dhe për rezultatet përfundimtare.

11. Ofruesi ose ofruesi i mundshëm do të jetë përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi për çdo dëm të shkaktuar gjatë testimit në kushte reale.

Neni 61

Pëlqimi i shprehur i informuar për të marrë pjesë në teste në kushte reale jashtë kuadrit rregullator të sandbox-eve për Inteligjencën Artificiale

1. Për qëllimin e testimit në kushte reale sipas nenit 60 të këtij ligji, duhet të merret paraprakisht pëlqimi i informuar dhe i dhënë lirisht nga subjektet e testimit, përpara pjesëmarrjes së tyre, pasi ato të jenë informuar në mënyrë të duhur me informacion të përmbledhur, të qartë, të rëndësishëm dhe të kuptueshëm në lidhje me:

- (a) natyrën dhe objektivat e testimit në kushte reale dhe shqetësimet e mundshme që mund të lidhen me pjesëmarrjen e tyre;
- (b) kushtet në të cilat do të zhvillohet testimi, përfshirë kohëzgjatjen e pritshme të pjesëmarrjes së subjektit ose subjekteve;
- (c) të drejtat e tyre dhe garancitë për pjesëmarrjen e tyre, në veçanti të drejtën për të refuzuar pjesëmarrjen dhe të drejtën për t'u tërhequr nga testimi në çdo kohë, pa pasoja negative dhe pa nevojë për të dhënë ndonjë justifikim;
- (d) rregullimet për kërkesën për kthimin pas ose injorimin e parashikimeve, rekomandimeve ose vendimeve të sistemit të IA-së;
- (e) numrin unik të identifikimit për testimin në kushte reale në nivel kombëtar sipas nenit 60 të këtij ligji(c), dhe të dhënat e kontaktit të ofruesit ose përfaqësuesit të tij ligjor nga ku mund të merret informacion shtesë.

2. Pëlqimi i informuar duhet të jetë i datuar dhe i dokumentuar, dhe një kopje e tij duhet t'u dorëzohet subjekteve të testimit ose përfaqësuesit të tyre ligjor.

Neni 62

Masat për ofruesit dhe përdoruesit, në veçanti NVM-të, përfshirë start-up-et

1. Autoritetet kompetente do të ndërmarrin veprimet e mëposhtme:

- (a) t'u japin NVM-ve, përfshirë start-up-et, që kanë seli të regjistruar ose degë në Republikën e Shqipërisë, akses të përparësuar në sandbox-et rregullatore të IA-së, për aq kohë sa ato plotësojnë kushtet e pranueshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes; ky akses i përparësuar nuk përjashton NVM-të e tjera që gjithashtu i plotësojnë këto kushte nga pjesëmarrja në sandbox;
- (b) të organizojnë aktivitete të veçanta të ndërgjegjësimit dhe trajnimit mbi zbatimin e këtij ligji, të përshtatura për nevojat e NVM-ve, përfshirë start-up-et, përdoruesit dhe, kur është e përshtatshme, autoritetet publike lokale;

- (c) të shfrytëzojnë kanalet ekzistuese të dedikuara dhe, kur është e nevojshme, të krijojnë të reja për komunikim me NVM-të, start-up-et, përdoruesit, inovatorët e tjerë dhe, sipas rastit, autoritetet publike lokale, për të dhënë këshilla dhe për të përgjigjur pyetjeve lidhur me zbatimin e këtij ligji, përfshirë pjesëmarrjen në sandbox-et rregullatore;
 - (d) të lehtësojnë pjesëmarrjen e NVM-ve dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm në procesin e zhvillimit të standardeve.
2. Interesat dhe nevojat specifike të ofruesve NVM, përfshirë start-up-et, do të merren parasysh kur përcaktohen tarifat për vlerësimin e konformitetit sipas nenit 43 të këtij ligji, duke i reduktuar ato në mënyrë proporcionale me madhësinë e tyre, madhësinë e tregut dhe tregues të tjerë përkatës.
3. Struktura e IA-sëdo të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:
- (a) të ofrojë modele standarde për fushat e mbuluara nga ky Rregullim, siç specifikohet nga Bordi në kërkesën e tij;
 - (b) të zhvillojë dhe mirëmbajë një platformë të vetme informacioni që ofron informacion të lehtë për t'u përdorur lidhur me këtë Rregullim për të gjithë operatorët në Republika e Shqipërisë;
 - (c) të organizojë fushata të përshtatshme komunikimi për të rritur ndërgjegjësimin rreth detyrimeve që rrjedhin nga ky Rregullim;
 - (d) të vlerësojë dhe promovojë përputhjen e praktikave më të mira në procedurat e prokurimit publik në lidhje me sistemet e IA-së.

Neni 63

Përrjashtime për operatorë specifike

1. Mikro-ndërmarrjet, sipas përkufizimit të legjislacionit në fuqi, mund të përmbushin disa elemente të sistemit të menaxhimit të cilësisë të kërkuar nga neni 17 i këtij ligji në një mënyrë të thjeshtuar, për aq kohë sa ato nuk kanë ndërmarrje partnere apo të lidhura sipas këtij Rekomandimi. Për këtë qëllim, Autoritetet kompetente do të zhvillojë udhëzime mbi elementet e sistemit të menaxhimit të cilësisë që mund të përmbushen në mënyrë të thjeshtuar, duke marrë parasysh nevojat e mikro-ndërmarrjeve, pa ndikuar në nivelin e mbrojtjes apo nevojën për konformitet me kërkesat për sistemet e IA-së me rrezik të lartë.
2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk duhet të interpretohet si përjashtim nga përmbushja e ndonjë kërkesë ose detyrimi tjetër të përcaktuar në këtë Rregullim, përfshirë ato të përcaktuara në nenet 9 të këtij ligji, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 72 dhe 73.

KREU VII

QEVERISJA

SEKSIONI 1

Qeverisja

Neni 64

Struktura për Inteligjencën Artificiale

1. AKSHI ushtron funksionin e Strukturës për Inteligjencën Artificiale, me qëllim koordinimin teknik, mbështetjen metodologjike, monitorimin e zbatimit të këtij ligji, nxitjen e ekspertizës dhe zhvillimin e kapaciteteve në Republikën e Shqipërisë në fushën e IA-së.
2. Struktura për Inteligjencën Artificiale, është përgjegjëse për monitorimin, koordinimin, raportimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.
3. AKSHI, në cilësinë e strukturës për IA-në, dhe autoritetet kompetente bashkëpunojnë me organizata ndërkombëtare dhe partnerë ndërkombëtarë për zbatimin e këtij ligji, brenda fushës së përgjegjësisë së tyre.
4. AKSHI harton raport vjetor mbi zbatimin e këtij ligji dhe ia paraqet Këshillit të Ministrave. Raporti mund të publikohet, duke respektuar legjisllacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin shtetëror, sigurinë kibernetike dhe informacionin konfidencial.

Neni 65

Themelimi dhe struktura e Bordit për Inteligjencën Artificiale

1. Themelohet Bordi Kombëtar për Inteligjencën Artificiale (“Bordi”).
2. Bordi përbëhet nga përfaqësues të ministrive përgjegjëse për fushat kryesore të zbatimit të këtij ligji dhe, sipas rastit, nga institucione qendrore të varësisë me përgjegjësi të drejtpërdrejtë në fushën e IA-së. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr pjesë si vëzhgues. AKSHI, në cilësinë e Strukturës për IA-në, merr pjesë në mbledhjet e Bordit dhe siguron sekretariatit teknik.
3. Përbërja institucionale e Bordit, në nivel pozicioni/funksioni, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Përfaqësuesit nominalë caktohen nga institucionet përkatëse për një periudhë trevjeçare, me të drejtë ricaktimi një herë.
4. Autoritetet kompetente sigurojnë që përfaqësuesit e tyre në Bord:
 - (a) të kenë kompetencat dhe fuqitë përkatëse në institucionin e tyre për të kontribuar në mënyrë aktive në përmbushjen e detyrave të Bordit, siç përcaktohet në nenin 66 të këtij ligji;
 - (b) të jenë të emëruar si pikë kontakti e vetme ndaj Bordit dhe, kur është e përshtatshme dhe sipas nevojave të Autoriteteve Kompetente, si pikë kontakti për palët e interesuara;
 - (c) të kenë mandatin për të lehtësuar konformitetin dhe koordinimin mes autoriteteve kompetente kombëtare lidhur me zbatimin e këtij ligji, përfshirë mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve përkatëse për përmbushjen e detyrave të tyre në Bord.
5. Përfaqësuesit e Bordit miratojnë rregulloren e brendshme me shumicë prej dy të tretash. Rregullorja e brendshme përcakton veçanërisht procedurat e mbledhjeve, mënyrën e vendimmarrjes, konfliktin e interesit dhe rregullat e dokumentimit të veprimtarisë së Bordit.
6. Bordi krijon dy nën-grupe të përhershme për të ofruar një platformë bashkëpunimi dhe shkëmbimi midis autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut dhe autoriteteve njoftuese mbi çështjet që lidhen përkatësisht me mbikëqyrjen e tregut dhe organet e njoftuara.

7. Nën-grupi për mbikëqyrjen e tregut do të veprojë si grupi i bashkëpunimit administrativ (ADCO) për këtë Ligj.

8. Bordi mund të krijojë edhe nën-grupe të tjera të përhershme ose të përkohshme, sipas nevojës, për shqyrtimin e çështjeve specifike. Përfaqësues të forumit këshillues të përmendur në nenin 67 të këtij ligji mund të ftohen në këto nën-grupe ose në mbledhje të caktuara të tyre si vëzhgues.

9. Bordi organizohet dhe funksionon në mënyrë që të garantojë objektivitetin dhe paanshmërinë e veprimtarisë së tij.

10. Bordi drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), me të drejtë vote. AKSHI siguron sekretariatën e Bordit, thërret mbledhjet me kërkesë të Kryetarit dhe përgatit rendin e ditës.

Neni 66

Detyrat e Bordit

1. Bordi këshillon dhe ndihmon ministritë dhe institucionet e varësisë për të lehtësuar zbatimin e qëndrueshëm dhe efektiv të këtij ligji. Në këtë drejtim, Bordi mund të:

- (a) kontribuojë në koordinimin midis autoriteteve kompetente kombëtare që janë përgjegjëse për zbatimin e këtij ligjidhe, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse të mbikëqyrjes së tregut dhe me pëlqimin e tyre, të mbështesë aktivitetet e përbashkëta të këtyre autoriteteve të përmendura në nenin 74 të këtij ligji(11);
- (b) mbledhë dhe ndajë ekspertizë teknike dhe rregullatore si dhe praktikën më të mira
- (c) japë këshilla mbi zbatimin e këtij ligji, veçanërisht lidhur me zbatimin e rregullave për modelet e inteligjencës artificiale me qëllim të përgjithshëm;
- (d) kontribuojë në harmonizimin e praktikave administrative, përfshirë përjashtimet nga procedurat e vlerësimit të konformitetit të përmendura në nenin 46 të këtij ligji, funksionimin e "sandbox"-eve rregullatore për IA dhe testimet në kushte reale, të përmendura në Nenet 57, 59 dhe 60;
- (e) me kërkesë të institucioneve ose me iniciativë të vet, të japë rekomandime dhe mendime të shkruara për çdo çështje të rëndësishme që lidhet me zbatimin e këtij ligji, duke përfshirë:
 - (i) zhvillimin dhe zbatimin e kodeve të sjelljes dhe kodeve të praktikës, si dhe udhëzimeve të Këshilli i Ministrave;
 - (ii) vlerësimin dhe rishikimin e këtij ligji, përfshirë raportet për incidente serioze (neni 73), funksionimin e bazës së të dhënave (neni 71), përgatitjen e akteve të deleguara apo zbatuese dhe konformitetin me legjislacionin e harmonizuar në Republikës së Shqipërisë të përmendur në Aneksin I të këtij ligji;
 - (iii) specifikimet teknike ose standardet ekzistuese që lidhen me kërkesat e përcaktuara në Kapitullin III, Seksioni 2;
 - (iv) përdorimin e standardeve të harmonizuara ose specifikimeve të përbashkëta të përmendura në Nenet 40 dhe 41;

- (v) trendet si konkurrueshmëria globale evropiane në fushën e IA, përthithja e IA në Republikën e Shqipërisë dhe zhvillimi i aftësive digjitale;
- (vi) trendet në evolucionin e tipologjisë së zinxhirëve të vlerës për IA, veçanërisht ndikimet në llogaridhënie;
- (vii) nevojën e mundshme për ndryshime në Aneksin III të këtij ligji sipas nenit 7 të këtij ligji dhe për rishikim të mundshëm të nenit 5 të këtij ligji, duke marrë parasysh dëshmitë dhe zhvillimet më të fundit teknologjike;
- (f) mbështesë në promovimin e edukimit mbi IA-në, ndërgjegjësimin publik dhe kuptimin e përfitimeve, rreziqeve, masave mbrojtëse, të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me përdorimin e sistemeve IA;
- (g) lehtësojë zhvillimin e kritereve të përbashkëta dhe një mirëkuptim të përbashkët ndërmjet operatorëve të tregut dhe autoriteteve kompetente për konceptet relevante në këtë Ligj, përfshirë kontributin në zhvillimin e standardeve krahasuese;
- (h) bashkëpunojë, sipas rastit, me institucionet, organet, Strukturat dhe agjencitë e tjera të Republikës së Shqipërisë, si dhe me grupet dhe rrjetet përkatëse të ekspertëve, veçanërisht në fushat e sigurisë së produkteve, sigurisë kibernetike, konkurrencës, shërbimeve digjitale dhe të medias, shërbimeve financiare, mbrojtjes së konsumatorit, të dhënave dhe të drejtave themelore;
- (i) kontribuojë në bashkëpunimin efektiv me autoritetet kompetente dhe me organizata ndërkombëtare;
- (j) ndihmojë autoritetet kompetente në zhvillimin e ekspertizës organizative dhe teknike të nevojshme për zbatimin e këtij ligji, përfshirë kontributin në vlerësimin e nevojave për trajnime për stafin përkatës;
- (k) ndihmojë AKSHI-n në mbështetjen e autoriteteve kombëtare për ngritjen dhe zhvillimin e “sandbox”-eve rregullatore për IA dhe lehtësojë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre;
- (l) kontribuojë dhe japë këshilla për zhvillimin e dokumenteve udhëzuese;
- (m) këshillojë në lidhje me çështjet ndërkombëtare në fushën e IA-së;
- (n) japë mendime mbi "alertat e kualifikuara" që lidhen me modelet e përgjithshme të IA-së;
- (o) pranojë mendime nga institucionet mbi këto alerta të kualifikuara dhe për përvojat dhe praktikat kombëtare në monitorimin dhe zbatimin e sistemeve të IA-së, veçanërisht atyre që përfshijnë modele të përgjithshme.

Neni 67

Forumi Këshillues

1. Themelohet një forum këshillues për të siguruar ekspertizë teknike dhe për të këshilluar Bordit, si dhe për të kontribuar në detyrat e tyre sipas këtij ligji.
2. Anëtarësia e forumit këshillues përbëhet nga një përzgjedhje e balancuar e palëve të interesuara, duke përfshirë industrinë, start-up-et, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, shoqërinë civile dhe

akademinë. Anëtarësia duhet të jetë e balancuar midis interesave tregtare dhe jo-tregtare dhe, brenda interesave tregtare, midis ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe ndërmarrjeve të tjera.

3. Këshilli i Ministrave përcakton procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të forumit këshillues, duke siguruar përfaqësim të balancuar të palëve të interesuara me ekspertizë në fushën e IA-së, akademisë, shoqërisë civile dhe sektorit privat.

4. Mandati i anëtarëve të forumit është dy vjet, i cili mund të zgjatet deri në maksimum katër vjet.

5. Forumi këshillues harton rregulloren e tij të brendshme. Zgjedh dy bashkryetarë nga anëtarët e tij, në përputhje me kriteret e pikës 2. Mandati i bashkryetarëve është dy vjet, me mundësi rinovimi një herë.

6. Forumi mban takime të paktën dy herë në vit. Mund të ftojë ekspertë dhe palë të tjera të interesuara në takimet e tij.

7. Forumi mund të përgatisë opinionë, rekomandime dhe kontribute të shkruara me kërkesë të Bordit.

8. Forumi mund të krijojë nën-grupe të përhershme ose të përkohshme për shqyrtimin e çështjeve specifike lidhur me objektivat e këtij ligji.

9. Forumi përgatit një raport vjetor për aktivitetet e tij, i cili publikohet.

Neni 68

Paneli Shkencor i Ekspertëve të Pavarur

1. Këshilli i Ministrave përcakton themelimin e një paneli shkencor të ekspertëve të pavarur (“paneli shkencor”) për të mbështetur aktivitetet e zbatimit të këtij ligji. Ky akt miratohet sipas procedurës së shqyrtimit të përmendur në nenin 96 të këtij ligji.

2. Paneli shkencor përbëhet nga ekspertë të përzgjedhur me vendim të Këshillit të Ministrave bazuar në ekspertizën e tyre shkencore ose teknike bashkëkohore në fushën e IA-së dhe duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- (a) të kenë ekspertizë dhe kompetencë të veçantë shkencore ose teknike në fushën e IA-së;
- (b) të jenë të pavarur nga çdo ofrues i sistemeve IA ose modeleve të përgjithshme të IA-së;
- (c) të jenë në gjendje të kryejnë detyrat me përkushtim, saktësi dhe objektivitet.

3. Këshilli i Ministrave, në konsultim me Bordit, përcakton numrin e ekspertëve në panel në përputhje me nevojat dhe siguron përfaqësim të drejtë gjinor dhe gjeografik.

4. Paneli shkencor këshillon dhe mbështet AKSHI-n për IA, veçanërisht për detyrat e mëposhtme:

- (a) mbështet zbatimin dhe zbatimin e këtij ligji për modelet dhe sistemet e përgjithshme të IA-së, duke përfshirë:
 - (i) paralajmërimin e AKSHI-t për IA për rreziqe sistemike në nivel në Republikën e Shqipërisë për modelet e përgjithshme të IA-së;
 - (ii) ndihmën në zhvillimin e mjeteve dhe metodologjive për vlerësimin e kapaciteteve të modeleve dhe sistemeve të përgjithshme të IA-së, përfshirë përmes standardeve krahasuese;
 - (iii) këshillimin për klasifikimin e modeleve të përgjithshme të IA-së me rrezik sistematik;

- (iv) këshillimin për klasifikimin e modeleve dhe sistemeve të ndryshme të përgjithshme të IA-së;
- (v) ndihmën në zhvillimin e mjeteve dhe mostrave;
- (b) mbështet punën e autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut, me kërkesë të tyre;
- (c) mbështet aktivitetet ndërkufitare të mbikëqyrjes së tregut, pa dëmtuar kompetencat e autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut;
- (d) mbështet AKSHI-n për IA në kryerjen e detyrave në kuadër të procedurës së masave mbrojtëse të Republikës së Shqipërisë.

5. Ekspertët e panelit kryejnë detyrat me paanshmëri, objektivitet dhe pavarësi profesionale, ruajnë konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave të marra gjatë kryerjes së punës dhe nuk kërkojnë apo marrin udhëzime nga asnjë autoritet publik ose subjekt privat për përmbajtjen e vlerësimeve të tyre.

6. Akti nënligjor i përmendur në pikën 1 të këtij neni përcakton kushtet, procedurat dhe rregullimet e hollësishme për mënyrën e funksionimit të panelit, nxjerrjen e paralajmërimeve, komunikimin me AKSHI-n në cilësinë e Strukturës për IA-në dhe bashkëpunimin me autoritetet kompetente.

Neni 69

Qasja e Institucioneve në grupin e ekspertëve

1. Institucionet mund të kërkojnë ndihmën e ekspertëve të panelit shkencor për të mbështetur aktivitetet e tyre të zbatimit në kuadër të këtij ligji.
2. Institucionet mund të jenë të detyruara të paguajnë tarifa për këshillat dhe mbështetjen e ofruar nga ekspertët. Struktura dhe niveli i tarifave si dhe shkalla dhe struktura e kostove të rikuperueshme përcaktohen në aktin zbatues të përmendur në nenin 68 të këtij ligji(1), duke marrë parasysh qëllimet e zbatimit të duhur të këtij ligji, efikasitetin e kostove dhe nevojën për të siguruar akses efektiv në ekspertë.
3. Autoritetet kompetente lehtësojnë aksesin në kohë të ekspertëve të panelit në informacionin dhe ekspertizën institucionale të nevojshme, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, sigurinë kibernetike, sekretin shtetëror dhe informacionin konfidencial.

SEKSIONI 2

Autoritetet kompetente

Neni 70

Caktimi i autoriteteve kompetente kombëtare dhe pikave të vetme të kontaktit

1. Autoritetet kompetente

Autoritetet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji janë:

- a) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si autoritet koordinues teknik;

b) autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut, i përcaktuar ose i krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për çështjet që lidhen me të dhënat personale.

d) Autoriteti njoftues, përgjegjës për emërimin dhe mbikëqyrjen e organeve të vlerësimit të konformitetit

2. Roli i AKSHI-t

AKSHI ushtron këto funksione:

- autoritet koordinues dhe pikë e vetme kontakti për inteligjencën artificiale;
- harton standarde dhe udhëzime teknike për sistemet e inteligjencës artificiale;
- administron infrastrukturën digjitale shtetërore që mbështet sistemet e IA-së;
- mbështet institucionet publike në zbatimin e këtij ligji.

AKSHI bashkëpunon me autoritetet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare për çështjet e inteligjencës artificiale.

3. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut ka të drejtë:

- të kërkojë çdo informacion, dokument apo të dhënë nga subjektet e këtij ligji;
- të kryejë inspektive, përfshirë inspektive në vend (on-site);
- të kryejë auditime teknike dhe organizative të sistemeve;
- autoriteti i mbikëqyrjes së tregut merr masa administrative
- të kërkojë akses në algoritme, dokumentacion teknik dhe regjistra;
- të intervistojë personat përgjegjës;
- të bashkëpunojë me autoritete të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kompetencat ushtrohen në përputhje me legjislacionin për mbikëqyrjen e tregut.

4. Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale

- mbikëqyr përpunimin e të dhënave personale në sistemet e inteligjencës artificiale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
- kryen kontrole dhe hetime administrative ndaj operatorëve që përdorin sisteme të inteligjencës artificiale që përpunojnë të dhëna personale.
- vendos sanksione administrative, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe këtë ligj.
- lëshon udhëzime dhe rekomandime për përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale në përputhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Autoriteti njoftues

- emëron dhe mbikëqyr organet e vlerësimit të konformitetit,
- verifikon përmbushjen e kritereve të tyre,
- pezullon ose tërheq statusin kur është e nevojshme,
- mban regjistrin përkatës dhe bashkëpunon me autoritetet kompetente dhe institucionet e akreditimit.

6. Autoritetet kompetente bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion në mënyrë të rregullt për zbatimin efektiv të këtij ligji.

7. Organizimi dhe funksionimi i autoriteteve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VIII

DATAVAZA PËR SISTEMET E IA-SË ME RREZIK TË LARTË

Neni 71

Databaza për sistemet e IA-së me rrezik të lartë të listuara në Aneksin III të këtij ligji

1. Me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi për databazat shtetërore, AKSHI do të krijojë dhe mirëmbajë një databazë që përmban informacionin e përmendur në paragrafët 2 dhe 3 të këtij Neni, në lidhje me sistemet e IA-së me rrezik të lartë të përmendura në nenin 6 të këtij ligji, të cilat janë të regjistruara në përputhje me Nenet 49 dhe 60, si dhe sistemet e IA-së që nuk konsiderohen si me rrezik të lartë sipas nenit 6 të këtij ligji dhe të cilat janë të regjistruara në përputhje me nenin 6 të këtij ligji dhe nenin 49 të këtij ligji. Gjatë përcaktimit të specifikimeve funksionale të kësaj databaze, AKSHI do të konsultohet me ekspertët përkatës, dhe gjatë përditësimit të specifikimeve funksionale do të konsultohet me Bordin.

2. Të dhënat e listuara në Seksionet A dhe B të Aneksit VIII të këtij ligji do të futen në databazë nga ofruesi ose, në rastin e zbatueshëm, nga përfaqësuesi i autorizuar.

3. Të dhënat e listuara në Seksionin C të Aneksit VIII të këtij ligji do të futen në databazë nga vendosësi që është, ose vepron në emër të, një autoritet publik, agjenci ose organ, në përputhje me nenin 49 të këtij ligji(3) dhe .

4. Përveç seksionit të përmendur në nenin 49 të këtij ligji(4) dhe nenin 60 të këtij ligji(4), pika (c), informacioni i përmbajtur në database-n evropiane të regjistruar sipas nenit 49 të këtij ligji do të jetë i aksesueshëm dhe publikisht i disponueshëm në një mënyrë të përshtatshme për përdoruesit. Informacioni duhet të jetë i lehtë për t'u naviguar dhe i lexueshëm nga makinat. Informacioni i regjistruar në përputhje me nenin 60 të këtij ligji do të jetë i aksesueshëm vetëm për autoritetet e mbikëqyrjes së tregut dhe Këshillin e Ministrave, përveç nëse ofruesi i ardhshëm ose ofruesi ka dhënë pëlqimin që informacioni të jetë gjithashtu i aksesueshëm për publikun.

5. Databaza do të përmbajë të dhëna personale vetëm në masën që është e nevojshme për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit në përputhje me këtë Ligj. Ky informacion do të përfshijë emrat

dhe të dhënat e kontaktit të personave fizikë që janë përgjegjës për regjistrimin e sistemit dhe kanë autoritet ligjor për të përfaqësuar ofruesin ose vendosësin, sipas rastit.

6. AKSHI do të jetë përgjegjës për kontrollin e kësaj databaze. Ai do të sigurojë mbështetje teknike dhe administrative të përshtatshme për ofruesit, ofruesit e ardhshëm dhe vendosësit. Databaza do të përputhet me kërkesat e vlefshme të aksesueshmërisë.

KREU IX

MBIKËQYRJA PAS HAPJES SË TREGUT, NDARJA E INFORMACIONIT DHE MBIKËQYRJA E TREGUT

SEKSIONI 1

Mbikëqyrja pas hapjes së tregut

Neni 72

Mbikëqyrja pas hapjes së tregut nga ofruesit dhe plani i mbikëqyrjes pas hapjes së tregut për sistemet e IA-së me rrezik të lartë

1. Ofruesit duhet të krijojnë dhe dokumentojnë një sistem mbikëqyrjeje pas hapjes së tregut në mënyrë proporcionale me natyrën e teknologjive të IA-së dhe rreziqet e sistemit të IA-së me rrezik të lartë.

2. Sistemi i mbikëqyrjes pas hapjes së tregut duhet të mbledhë në mënyrë aktive dhe sistematike, të dokumentojë dhe analizojë të dhëna relevante të siguruara nga vendosësit ose të mbledhura nga burime të tjera mbi performancën e sistemeve të IA-së me rrezik të lartë gjatë gjithë kohëzgjatjes së tyre, dhe të lejojë ofruesin të vlerësojë konformitetin e vazhdueshme të sistemeve të IA-së me kërkesat e përcaktuara në Kapitullin III, Seksioni 2. Kur është e nevojshme, mbikëqyrja pas hapjes së tregut duhet të përfshijë një analizë të ndërveprimit me sisteme të tjera të IA-së. Ky detyrim nuk mbulon të dhënat sensitive operative të vendosësve që janë autoritete ligjzbatuese.

3. Sistemi i mbikëqyrjes pas hapjes së tregut duhet të bazohet në një plan mbikëqyrjeje pas hapjes së tregut. Ky plan do të jetë pjesë e dokumentacionit teknik të përmendur në Aneksin IV të këtij ligji. Këshilli i Ministrave do të miratojë një akt zbatues që përcakton rregulla të detajuara, duke vendosur një model për planin e mbikëqyrjes pas hapjes së tregut dhe listën e elementeve që duhet të përfshihen në plan. Ky akt zbatues do të miratohet në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 96 të këtij ligji.

4. Për sistemet e IA-së me rrezik të lartë të mbuluara nga ligji i harmonizuar i Republikës së Shqipërisë të listuar në Seksionin A të Aneksit I të këtij ligji, ku sistemi dhe plani i mbikëqyrjes pas hapjes së tregut janë tashmë vendosur sipas atij ligji, për të siguruar koherencë, shmangie të dyfishimeve dhe minimizim të barrës shtesë, ofruesit mund të zgjedhin të integrojnë, sipas nevojës, elementët e nevojshëm të përshkruar në paragrafët 1, 2 dhe 3 duke përdorur modelin e përmendur në paragraf 3 në sistemet dhe planet tashmë ekzistuese sipas atij ligji, për sa kohë që arrihet një nivel ekuivalent mbrojtjeje.

5. Ky nën-paragraf aplikohet gjithashtu për sistemet e IA-së me rrezik të lartë të përmendura në pikën 5 të Aneksit III të këtij ligji, të vendosura në treg ose në shërbim nga institucionet financiare që i nënshtrohen kërkesave sipas ligjit të shërbimeve financiare në Republikën e Shqipërisë për qeverisjen e tyre të brendshme, rregullimet ose proceset.

SEKSIONI 2

Ndarja e informacionit mbi incidentet serioze

Neni 73

Raportimi i incidenteve serioze

1. Ofruesit e sistemeve të IA-së me rrezik të lartë të vendosura në tregun e Republikën e Shqipërisë duhet të raportojnë çdo incident serioz autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut ku ka ndodhur incidenti.
2. Raporti i përmendur në paragraf 1 duhet të bëhet menjëherë pasi ofruesi të ketë vendosur një lidhje shkakësore midis sistemit të IA-së dhe incidentit serioz ose një mundësi të arsyeshme për ekzistencën e një lidhjeje të tillë, dhe në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë pas kohës kur ofruesi ose, në rastin e duhur, vendosësi merr njohuri për incidentin serioz.
3. Afati për raportim duhet të marrë parasysh ashpërsinë e incidentit serioz.
4. Pavarësisht nga pika 2, në rastin e një shkeljeje të përhapur ose një incidenti serioz siç përcaktohet në nenit 3 të këtij ligji, pika (b), raporti duhet të dorëzohet menjëherë, dhe jo më vonë se dy ditë pas njohjes së incidentit nga ofruesi ose vendosësi.
5. Pavarësisht pikës 2, në rast vdekjeje të një personi, raporti duhet të dorëzohet menjëherë pas vendosjes ose dyshimit për lidhjen shkakësore midis sistemit të IA-së me rrezik të lartë dhe incidentit serioz, por jo më vonë se 10 ditë pas ditës kur ofruesi ose vendosësi merr njohuri për incidentin.
6. Kur është e nevojshme për të siguruar raportim në kohë, ofruesi ose vendosësi mund të dorëzojë një raport fillestar të paplotë, i ndjekur nga një raport i plotë.
7. Pas raportimit të një incidenti serioz sipas pikës 1, ofruesi duhet të kryejë menjëherë hetimet e nevojshme lidhur me incidentin dhe sistemin e IA-së në fjalë. Kjo përfshin vlerësimin e rrezikut të incidentit dhe veprime korrigjuese.
8. Ofruesi duhet të bashkëpunojë me autoritetet kompetente dhe, kur është e nevojshme, me organin e njoftuar përkatës gjatë hetimeve dhe nuk duhet të kryejë asnjë hetim që përfshin ndryshimin e sistemit të IA-së në mënyrë që të mos ndikojë në vlerësimin pasues të shkaqeve të incidentit, para se të njoftojë autoritetet kompetente për veprimet e tilla.
9. Pasi të marrë një njoftim për një incident serioz sipas nenit 3 të këtij ligji, pika (c), autoriteti për mbikëqyrjen e tregut duhet të informojë autoritetet ose organet publike kombëtare të përmendura në nenit 77 të këtij ligji(1).

10. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut duhet të marrë masa të përshtatshme, sipas legjislacionit në fuqi, brenda shtatë ditëve nga marrja e njoftimit dhe të ndjekë procedurat e njoftimit siç parashikohet në atë Ligj.

11. Për sistemet e IA-së me rrezik të lartë të përmendura në Aneksin III të këtij ligji, të vendosura në treg ose në shërbim nga ofrues që i nënshtrohen instrumenteve ligjore në Republikën e Shqipërisë me detyrime raportimi ekuivalente me ato të këtij ligji, njoftimi i incidenteve serioze do të kufizohet vetëm në ato të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, pika (c).

12. Për sistemet e IA-së me rrezik të lartë që janë komponentë sigurie të pajisjeve, ose vetë pajisje, njoftimi i incidenteve serioze do të kufizohet vetëm në ato të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, pika (c) të këtij ligji, dhe do të bëhet tek autoriteti kompetent kombëtar i zgjedhur për këtë qëllim.

13. Autoritetet kompetente kombëtare duhet të njoftojnë menjëherë Këshillin e Ministrave për çdo incident serioz, pavarësisht nëse kanë marrë masa apo jo, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen e tregut.

SEKSIONI 3

Zbatimi

Neni 74

Mbikëqyrja e tregut dhe kontrolli i sistemeve të IA në tregun e Republikës së Shqipërisë

1. Legjislacioni për mbikëqyrjen e tregut, sigurinë e produkteve, vlerësimin e konformitetit, mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë kibernetike zbatohet për sistemet e IA-së të përfshira nga ky ligj. Për qëllimet e zbatimit efektiv të këtij ligji:

(a) çdo referencë ndaj një operatori ekonomik në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen e tregut duhet të kuptohet duke përfshirë të gjithë operatorët e identifikuar në nenin 2 të këtij ligji(1) të këtij ligji;

(b) çdo referencë ndaj një produkti në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen e tregut duhet të kuptohet duke përfshirë të gjitha sistemet e IA që hyjnë në fushën e zbatimit të këtij ligji.

2. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut duhet të raportojnë çdo vit dhe autoriteteve kombëtare të konkurrencës informacionet e identifikuar gjatë aktiviteteve të mbikëqyrjes së tregut që mund të jenë me interes për zbatimin e ligjit në Republikën e Shqipërisë në fushën e rregullave të konkurrencës. Gjithashtu, ata duhet të raportojnë çdo vit për përdorimin e praktikave të ndaluara që kanë ndodhur gjatë atij viti dhe për masat e ndërmarra.

3. Për sistemet e IA me rrezik të lartë që lidhen me produktet e mbuluara nga legjislacioni i harmonizimit në Republikës së Shqipërisë të listuar në Seksionin A të Aneksit I të këtij ligji, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut për qëllimet e këtij ligji është autoriteti përgjegjës për aktivitetet e mbikëqyrjes së tregut të caktuar sipas atyre akteve ligjore.

4. Procedurat e përmendura në nenet 79 të këtij ligji deri 83 të këtij ligjinuk zbatohen për sistemet e IA që lidhen me produktet e mbuluara nga legjislacioni i harmonizimit në Republikës së Shqipërisë të listuar në Seksionin A të Aneksit I të këtij ligji, kur ato akte ligjore tashmë

parashikojnë procedura që sigurojnë një nivel të barabartë mbrojtjeje dhe që kanë të njëjtin qëllim. Në këto raste, zbatohen procedurat sektoriale përkatëse.

5. Për sistemet e IA-së me rrezik të lartë të vendosura në treg, të vëna në shërbim ose të përdorura nga institucionet financiare, autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen sektoriale përcaktohet sipas legjislacionit përkatës financiar. Rregullat e bashkëpunimit me autoritetet kompetente të këtij ligji përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave ose me marrëveshje bashkëpunimi ndërinstytucionale, sipas rastit.

6. Autoritetet kombëtare të mbikëqyrjes së tregut që mbikëqyrin institucionet e kreditit, duhet të raportojnë pa vonesë Bankës Qendrore çdo informacion të identifikuar gjatë aktiviteteve të tyre të mbikëqyrjes së tregut që mund të jetë me interes për detyrat mbikëqyrëse prudenciale të Bankës Qendrore të Shqipërisë.

7. Për sistemet e IA-së me rrezik të lartë që përpunojnë të dhëna personale ose që përdoren në fusha ku përpunimi i të dhënave personale është thelbësor, autoriteti mbikëqyrës kompetent është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda kompetencave të përcaktuara nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

8. Kur institucionet, organet, Strukturat ose agjencitë e Republikën e Shqipërisë brenda fushës së këtij ligji, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave do të veprojë si autoriteti i tyre mbikëqyrës i tregut, përveç në lidhje me Gjykatat në Republikën e Shqipërisë

9. Autoritetet kompetente duhet të lehtësojnë koordinimin midis autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut të caktuara sipas këtij ligji dhe autoriteteve ose organeve kombëtare të tjera relevante që mbikëqyrin zbatimin e legjislacionit të harmonizimit në Republikës së Shqipërisë të listuar në Aneksin I të këtij ligji, ose në ligjin tjetër të Republikës së Shqipërisë, që mund të jenë relevante për sistemet e IA me rrezik të lartë të përmendura në Aneksin III të këtij ligji.

10. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut dhe autoritetet e tjera kompetente mund të propozojnë dhe të zhvillojnë veprimtari të përbashkëta, përfshirë inspektime ose hetime të përbashkëta, kur kjo është e nevojshme për zbatimin efektiv të këtij ligji dhe brenda kompetencave të tyre ligjore.

11. Pa çenuar legjislacionin në fuqi autoritetet e mbikëqyrjes së tregut duhet të kenë akses të plotë nga ofruesit në dokumentacionin si dhe në të dhënat e trajnimit, verifikimit dhe testimit të përdorura për zhvillimin e sistemeve të IA me rrezik të lartë, përfshirë, kur është e përshtatshme dhe me kusht sigurimin e masave të sigurisë, përmes ndërfaqeve të programimit të aplikacioneve (API) ose mjeteve teknike dhe mënyrave të tjera të përshtatshme që mundësojnë akses në distancë.

12. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut duhet të kenë akses në kodin burim të sistemit të IA me rrezik të lartë pas një kërkesë të arsyetuar dhe vetëm kur plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:

(a) akses në kodin burim është i nevojshëm për të vlerësuar konformitetin e një sistemi të IA me rrezik të lartë me kërkesat e përcaktuara në Kapitullin III, Seksioni 2; dhe

(b) procedurat e testimit ose auditimit dhe verifikimet bazuar në të dhënat dhe dokumentacionin e siguruar nga ofruesi janë shteruar ose kanë rezultuar të pamjaftueshme.

13. Çdo informacion ose dokumentacion i marrë nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut duhet të trajtohet në përputhje me detyrimet e konfidencialitetit të përcaktuara në nenin 78 të këtij ligji.

Neni 75

Ndihma e ndërsjellë, mbikëqyrja e tregut dhe kontrolli i sistemeve të IA me qëllim të përgjithshëm

1. Kur një sistem IA bazohet në një model të IA-së me qëllim të përgjithshëm, dhe modeli dhe sistemi janë zhvilluar nga i njëjti ofrues, Struktura e IA-së ka kompetenca për të monitoruar dhe mbikëqyrur konformitetin e atij sistemi i IA-së me detyrimet nën këtë Ligj. Për të kryer detyrat e monitorimit dhe mbikëqyrjes, Struktura e IA-së do të ketë të gjitha fuqitë e një autoriteti të mbikëqyrjes së tregut që parashikohen në këtë Seksion sipas legjisllacionit përkatës..
2. Kur autoritetet përkatëse të mbikëqyrjes së tregut kanë arsye të mjaftueshme të konsiderojnë sistemet e IA me qëllim të përgjithshëm që mund të përdoren direkt nga përdoruesit për të paktën një qëllim të klasifikuar si me rrezik të lartë sipas këtij ligji, si jo të përputhshme me kërkesat e vendosura në këtë Ligj, ato bashkëpunojnë me Strukturën e IA-së për të kryer vlerësime të konformitetit dhe informojnë Bordet dhe autoritetet e tjera të mbikëqyrjes së tregut përkatësisht.
3. Kur një autoritet mbikëqyrës i tregut nuk është në gjendje të përfundojë hetimin e sistemit IA me rrezik të lartë për shkak të pamundësisë për të pasur akses në informacion të caktuar që lidhet me modelin IA me qëllim të përgjithshëm, pavarësisht përpjekjeve të bëra për ta marrë atë informacion, mund të bëjë një kërkesë të arsyetuar ndaj Zyrës së IA-së, për të cilën duhet të bëhet e mundur aksesimi i atij informacioni. Në atë rast, Struktura e IA-së duhet t'i sigurojë autoritetit kërkuar pa vonesë, dhe në çdo rast brenda 30 ditëve, çdo informacion që Struktura e IA-së e konsideron të rëndësishëm për të përcaktuar nëse sistemi i IA-së me rrezik të lartë është jo i përputhshëm. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut duhet të ruajnë konfidencialitetin e informacionit që marrin në përputhje me nenin 78 të këtij ligji të këtij ligji.

Neni 76

Mbikëqyrja e testimit në kushte reale nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut

1. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut kanë kompetenca dhe fuqi për të siguruar që testimi në kushte reale bëhet në përputhje me këtë Ligj.
2. Kur testimi në kushte reale bëhet për sistemet e IA që mbikëqyren brenda një rregulli për sandbox-in e IA-së sipas nenit 58 të këtij ligji, autoritetet e mbikëqyrjes së tregut verifikojnë konformitetin me nenin 60 të këtij ligji si pjesë të rolit të tyre mbikëqyrës për sandbox-in e IA-së. Ata mund, sipas rastit, të lejojnë që testimi në kushte reale të kryhet nga ofruesi ose ofruesi i mundshëm, duke bërë përjashtim nga kushtet e përcaktuara në nenin 60 të këtij ligji(4), pika (f) dhe (g).
3. Kur një autoritet i mbikëqyrjes së tregut është informuar nga ofruesi i mundshëm, ofruesi ose ndonjë palë e tretë për një incident serioz ose ka arsye të mendojë se kushtet e përcaktuara në nenin 60 të këtij ligji dhe 61 nuk janë përmbushur, mund të marrë një vendim nga këto vendime në territorin e tij, sipas rastit:
 - (a) pezullimin ose ndalimin e testimit në kushte reale;

(b) kërkimin nga ofruesi ose ofruesi i mundshëm dhe nga përdoruesi ose përdoruesi i mundshëm të modifikojnë çdo aspekt të testimin në kushte reale.

4. Kur një autoritet i mbikëqyrjes së tregut ka marrë një vendim si në pikën 3 ose ka ngritur një kundërshtim sipas nenit 60 të këtij ligji(4), pika (b), vendimi ose kundërshtimi duhet të tregojë arsyet e tij dhe mënyrën se si ofruesi ose ofruesi i mundshëm mund ta sfidojë atë vendim ose kundërshtim.

5. Kur është e aplikueshme, dhe kur një autoritet i mbikëqyrjes së tregut ka marrë vendimin si në pikën 3, ai duhet të komunikojë arsyet për këtë vendim tek autoritetet e mbikëqyrjes së tregut të vendeve të tjera anëtare ku sistemi i IA-së është testuar në përputhje me planin e testimin.

Neni 77

Detyrimet e autoriteteve për mbrojtjen e të drejtave themelore

1. Autoritetet publike kombëtare ose organet që mbikëqyrin ose zbatojnë respektimin e detyrimeve nën ligjin e Republikën e Shqipërisë që mbrojnë të drejtat themelore, përfshirë të drejtën ndaj diskriminimit, lidhur me përdorimin e sistemeve IA me rrezik të lartë të referuara në Anexin III, kanë fuqi për të kërkuar dhe për të pasur akses në çdo dokumentacion të krijuar ose të mbajtur sipas këtij ligjin në një gjuhë dhe format të aksesueshëm, kur ky akses është i nevojshëm për përmbushjen efektive të mandateve të tyre brenda kufijve të juridiksionit të tyre. Autoriteti publik ose organi përkatës duhet të informojë autoritetin e mbikëqyrjes së për çdo kërkesë të tillë.

2. Kur dokumentacioni i përmendur në pikën 1 është i pamjaftueshëm për të vërtetuar nëse ka ndodhur shkelje e detyrimeve sipas ligjit në Republikën e Shqipërisë që mbrojnë të drejtat themelore, autoriteti publik ose organi i përmendur në pikën 1 mund të bëjë një kërkesë të arsyetuar ndaj autoritetit të mbikëqyrjes së tregut, për të organizuar testimin e sistemit IA me rrezik të lartë përmes mjeteve teknike. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut duhet të organizojë testimin me përfshirjen e ngushtë të autoritetit publik ose organit kërkues brenda një kohe të arsyeshme pas kërkesës.

3. Çdo informacion ose dokumentacion i marrë nga autoritetet publike kombëtare ose organet e përmendura në pikën 1 sipas këtij neni do të trajtohet në përputhje me detyrimet e konfidencialitetit të përcaktuara në nenin 78 të këtij ligji.

Neni 78

Konfidencialiteti

1. Këshilli i Ministrave, autoritetet e mbikëqyrjes së tregut, organet e njoftuara dhe çdo person fizik ose juridik i përfshirë në zbatimin e këtij ligji ruajnë konfidencialitetin e informacionit të marrë, në përputhje me legjislacionin për sekretin tregtar, sekretin shtetëror, mbrojtjen e të dhënave personale, sigurinë kibernetike dhe të drejtën e informimit.

(a) të drejtat e pronës intelektuale dhe informacionin konfidencial të biznesit ose sekretet tregtare të një personi fizik ose juridik, përfshirë kodin burim

(b) zbatimin efektiv të këtij ligji, veçanërisht për qëllimet e inspektimeve, hetimeve ose auditimeve;

- (c) interesat e sigurisë publike dhe kombëtare;
- (d) zhvillimin e procedurave penale ose administrative;
- (e) informacionin e klasifikuar sipas legjislacionit në fuqi.

2. Autoritetet e përfshira në zbatimin e këtij ligjisipas pikës 1 duhet të kërkojnë vetëm të dhëna që janë domosdoshmërisht të nevojshme për vlerësimin e rrezikut që paraqesin sistemet e IA-së dhe për ushtrimin e kompetencave të tyre në përputhje me këtë Ligj. Ata duhet të vendosin masa të përshtatshme dhe efektive të sigurisë kibernetike për të mbrojtur sigurinë dhe konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave të marra, dhe të fshijnë të dhënat e mbledhura sa më shpejt që nuk do të jenë më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë marrë, në përputhje me ligjin e zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë.

3. Pa çënuar paragrafët 1 dhe 2, informacioni i shkëmbyer në bazë konfidenciale midis autoriteteve kombëtare kompetente nuk duhet të zbulohet pa konsultim paraprak me autoritetin kompetent kombëtar origjinal dhe me përdoruesin, kur sistemet e IA-së me rrezik të lartë të përmendura në pikat 1, 6 ose 7 të Anexës III përdoren nga autoritetet e zbatimit të ligjit, kontrollit kufitar, imigracionit ose azilit dhe kur një zbulim i tillë do të rrezikonte interesat e sigurisë publike dhe kombëtare. Ky shkëmbim informacioni nuk duhet të përfshijë të dhëna operationale të ndjeshme lidhur me veprimtaritë e autoriteteve të zbatimit të ligjit, kontrollit kufitar, imigracionit ose azilit.

4. Kur autoritetet e zbatimit të ligjit, imigracionit ose azilit janë ofrues të sistemeve IA me rrezik të lartë të përmendura në pikat 1, 6 ose 7 të Anexës III, dokumentacioni teknik i përmendur në Anexën IV duhet të qëndrojë brenda ambienteve të atyre autoriteteve. Ata autoritete duhet të sigurojnë që autoritetet e mbikëqyrjes së tregut të referuara në nenin 74 të këtij ligji(8) dhe, siç aplikohet, të kenë, sipas kërkesës, akses të menjëhershëm në dokumentacion ose të marrin një kopje të tij. Vetëm stafi i autoritetit të mbikëqyrjes së tregut që ka nivelin e duhur të sigurisë duhet të ketë të drejtë akses në atë dokumentacion ose kopje të tij.

5. Paragrafët 1, 2 dhe 3 nuk ndikojnë në të drejtat ose detyrimet e autoriteteve kompetente, si dhe të organeve të njoftuara, në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe përhapjen e paralajmërimeve, përfshirë në kuadër të bashkëpunimit ndër-kufitar, dhe as nuk ndikojnë në detyrimet e palëve përkatëse për të siguruar informacion në bazë të ligjit penal të Republikës së Shqipërisë..

6. Autoritetet kompetente, kur është e nevojshme dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare dhe tregtare të zbatueshme, shkëmbejnë informacion konfidencial me autoritetet rregullatore të shteteve të tjera, duke respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretin shtetëror dhe informacionin konfidencial.

Neni 79

Procedura në nivel kombëtar për trajtimin e sistemeve IA që paraqesin rrezik

1. Sistemet IA që paraqesin rrezik kuptohen si “produkt që paraqet rrezik”, në masën që ato paraqesin rreziqe për shëndetin ose sigurinë, ose për të drejtat themelore të personave.

2. Kur autoriteti i mbikëqyrjes së tregut ka arsye të mjaftueshme të konsiderojë se një sistem IA paraqet rrezik, siç përmendet në pika 1 të këtij neni, ai duhet të kryejë një vlerësim të sistemit IA në lidhje me konformitetin e tij me të gjitha kërkesat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë Ligj. Vëmendje e veçantë i kushtohet sistemeve IA që paraqesin rrezik për grupet e cenueshme. Kur identifikohen rreziqe për të drejtat themelore, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut duhet gjithashtu të informojë dhe të bashkëpunojë plotësisht me autoritetet ose organet publike kombëtare përkatëse, të përmendura në nenin 77 të këtij ligji(1). Operatorët përkatës duhet të bashkëpunojnë sipas nevojës me autoritetin e mbikëqyrjes së tregut dhe me organet publike kombëtare të përmendura në nenin 77 të këtij ligji(1).

3. Nëse gjatë këtij vlerësimi, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut, ose, kur aplikohet, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut në bashkëpunim me organin publik kombëtar të përmendur në nenin 77 të këtij ligji, konstatojnë se sistemi i IA-së nuk është në përputhje me kërkesat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë Ligj, ai duhet pa vonesë të kërkojë nga operatori përkatës të ndërmarrë të gjitha veprimet korrektuese të përshtatshme për të bërë sistemin IA në përputhje, të tërheqë sistemin IA nga tregu, ose të bëjë thirrje për tërheqjen e tij brenda një periudhe që mund të përcaktojë autoriteti i mbikëqyrjes së tregut, dhe në çdo rast brenda 15 ditëve pune, ose siç përcaktohet në legjislacionin përkatës të harmonizuar të Republikës së Shqipërisë.

4. Autoriteti i mbikëqyrjes së tregut duhet të informojë përkatësisht organin e njoftuar.

5. Kur autoriteti i mbikëqyrjes së tregut konsideron se mos-konformiteti nuk është e kufizuar vetëm në territorin e tij kombëtar, ai duhet pa vonesë të informojë për rezultatet e vlerësimit dhe veprimet që ka kërkuar nga operatori.

6. Operatori duhet të sigurojë që të gjitha veprimet korrektuese të përshtatshme të ndërmerren për të gjitha sistemet e IA-së të përfshira që ai ka vënë në dispozicion në tregun e Republikës së Shqipërisë.

7. Kur operatori i një sistemi i IA-së nuk ndërmerr veprime korrektuese të mjaftueshme brenda periudhës së përmendur në pika 2, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut duhet të marrë të gjitha masat e përkohshme të përshtatshme për të ndaluar ose kufizuar vënien në dispozicion ose vënien në shërbim të sistemit IA në tregun kombëtar, për të tërhequr produktin ose sistemin IA nga ai treg ose për ta tërhequr atë. Ky autoritet duhet pa vonesë të njoftojë për këto masa.

8. Njoftimi i përmendur në paragraf 5 duhet të përfshijë të gjitha detajet e disponueshme, veçanërisht informacionin e nevojshëm për identifikimin e sistemit IA jo-konform, origjinën e sistemit IA dhe zinxhirin e furnizimit, natyrën e mos-konformitetit së pretenduar dhe rrezikun e përfshirë, natyrën dhe kohëzgjatjen e masave kombëtare të marra dhe argumentet e paraqitura nga operatori përkatës. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut duhet të tregojnë në veçanti nëse mos-konformiteti është për shkak të një ose më shumë prej të mëposhtmeve:

(a) mos-konformitet me ndalimin e praktikave IA të përmendura në nenin 5 të këtij ligji;

(b) mos-përmbushje e një sistemi i IA-së me rrezik të lartë me kërkesat e përcaktuara në Kapitullin III, Seksioni 2;

(c) mangësi në standardet e harmonizuara ose specifikimet e përbashkëta të përmendura në Nenët 40 dhe 41 që japin supozimin e konformitetit;

(d) mos-konformitet me nenin 50 të këtij ligji.

9. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut, përveç atij që ka nisur procedurën, duhet pa vonesë të informojnë autoritetet kompetente për çdo masë të miratuar dhe për çdo informacion shtesë në dispozicion në lidhje me mos-konformitetin e sistemit IA në fjalë dhe, në rast të mosmarrëveshjes me masën kombëtare të njoftuar, për kundërshtimet e tyre.

10. Kur brenda tre muajve nga marrja e njoftimit të përmendur në paragraf 5 nuk ka pasur kundërshtime nga ndonjë autoritet i mbikëqyrjes së tregut në lidhje me një masë të përkohshme të marrë nga një autoritet i mbikëqyrjes së tregut, masa konsiderohet e justifikuar. Afati tre-mujor i përmendur në këtë paragraf reduktohet në 30 ditë në rast mos-konformitete me ndalimin e praktikave IA të përmendura në nenin 5 të këtij ligji të këtij ligji.

11. Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut duhet të sigurojnë që të merren masat kufizuese të përshtatshme ndaj produktit ose sistemit IA në fjalë, si tërheqja e produktit ose sistemit nga tregu, pa vonesë të tepruar.

Neni 80

Procedura për trajtimin e sistemeve të IA të klasifikuara nga ofruesi si jo me rrezik të lartë në zbatimin e Aneksit III të këtij ligji

1. Kur autoriteti i mbikëqyrjes së tregut ka arsye të mjaftueshme të konsiderojë se një sistem IA i klasifikuar nga ofruesi si jo me rrezik të lartë sipas nenit 6 të këtij ligji(3) është në të vërtetë me rrezik të lartë, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut do të kryejë një vlerësim të sistemit IA në fjalë lidhur me klasifikimin e tij si sistem IA me rrezik të lartë, bazuar në kushtet e përcaktuara në nenit 6 të këtij ligji(3) dhe udhëzimet e Autoritetit kompetent.

2. Kur, gjatë këtij vlerësimi, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut gjen se sistemi i IA-së në fjalë është me rrezik të lartë, ai pa vonesë të panevojshme do t'i kërkojë ofruesit përkatës të marrë të gjitha masat e nevojshme për të sjellë sistemin IA në përputhje me kërkesat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë Ligj, si dhe të marrë masa korigjuese të përshtatshme brenda një periudhe që autoriteti i mbikëqyrjes së tregut mund të përcaktojë.

3. Kur autoriteti i mbikëqyrjes së tregut konsideron se përdorimi i sistemit IA në fjalë nuk është i kufizuar vetëm në territorin e tij kombëtar, ai do të informojë autoritetet kompetente pa vonesë të panevojshme për rezultatet e vlerësimit dhe për veprimet që i ka kërkuar ofruesit të ndërmarrë.

4. Ofruesi do të sigurojë që të gjitha veprimet e nevojshme të ndërmerren për të sjellë sistemin IA në përputhje me kërkesat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë Ligj. Nëse ofruesi i një sistemi i IA-së në fjalë nuk e sjell sistemin IA në përputhje me ato kërkesa dhe detyrime brenda periudhës së referuar në pika 2 të këtij Neni, ofruesi do të jetë subjekt i gjobave sipas nenit 99 të këtij ligji.

5. Ofruesi do të sigurojë që të merren të gjitha masat korigjuese të përshtatshme për të gjitha sistemet e IA-së në fjalë që ai ka vënë në dispozicion në tregun e Republikës së Shqipërisë.

6. Nëse ofruesi i sistemit IA në fjalë nuk merr masa korrigjuese të përshtatshme brenda periudhës së referuar në pika 2 të këtij Neni, do të zbatohen Nenet 79 deri në .

7. Kur gjatë vlerësimit sipas pikës 1 të këtij Neni, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut konstaton se sistemi i IA-së është klasifikuar gabimisht nga ofruesi si jo me rrezik të lartë për të shmangur zbatimin e kërkesave në Kapitullin III, Seksioni 2, ofruesi do të jetë subjekt i gjobave sipas nenit 99 të këtij ligji.

8. Gjatë ushtrimit të kompetencës së tyre për të monitoruar zbatimin e këtij neni dhe në përputhje dshe në përputhje me legjislacionin përkatës, autoritetet e mbikëqyrjes së tregut mund të kryejnë kontrole të përshtatshme, duke marrë parasysh veçanërisht informacionin e ruajtur në bazën e të dhënave të referuar në nenin 71 të këtij ligji të këtij ligji.

Neni 81

Procedura e sigurimit të Republikës së Shqipërisë

1. Kur brenda tre muajve nga marrja e njoftimit të referuar në nenit 79 të këtij ligji, ose brenda 30 ditëve në rastin e mosrespektimit të ndalimit të praktikave të IA të referuara në nenit 5 të këtij ligji, ngrihen kundërshtime nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut ndaj një masë të marrë nga një autoritet tjetër i mbikëqyrjes së tregut, ose kur autoriteti kompetent konsideron se masa është në kundërshtim me ligjin e Republikës së Shqipërisë, autoritetet kompetente pa vonesë të panevojshme do të hyjë në konsultim me autoritetin e mbikëqyrjes së tregut dhe operatorin ose operatorët dhe do të vlerësojë masën kombëtare. Bazuar në rezultatet e këtij vlerësimi, autoriteti kompetent do të vendosë brenda gjashtë muajve, ose brenda 60 ditëve në rastin e mosrespektimit të ndalimit të praktikave të IA të referuara në nenit 5 të këtij ligji, duke filluar nga njoftimi i referuar në nenit 79 të këtij ligji, nëse masa kombëtare është e justifikuar dhe do t'i njoftojë vendimin autoritetit të mbikëqyrjes së tregut. Autoriteti kompetent gjithashtu do t'i informojë të gjitha autoritetet e tjera të mbikëqyrjes së tregut për vendimin e tij.

2. Kur autoriteti mbikëqyrës konsideron se masa e marrë është e justifikuar, autoritetet e tjera kompetente sigurojnë marrjen e masave kufizuese të përshtatshme lidhur me sistemin e IA-së në fjalë, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë.

3. Kur masa kombëtare konsiderohet e justifikuar dhe mosrespektimi i sistemit IA i atribuohet mangësive në standardet e harmonizuara ose specifikimet e përbashkëta të referuara në Nenet 40 dhe 41 të këtij ligji, autoriteti kompetent do të aplikojë legjislacionin në fuqi për standartizimin.

Neni 82

Sistemet e IA në përputhje që paraqesin një rrezik

1. Kur, pas kryerjes së një vlerësimi sipas nenit 79 të këtij ligji, pas konsultimit me autoritetin publik kombëtar përkatës të referuar në nenin 77 të këtij ligji, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut gjen se, megjithëse një sistem IA me rrezik të lartë përputhet me këtë Ligj, ai megjithatë paraqet një rrezik për shëndetin ose sigurinë e personave, për të drejtat themelore, ose për aspekte të tjera të mbrojtjes së interesit publik, ai do t'i kërkojë operatorit përkatës të marrë të gjitha masat e përshtatshme për

të siguruar që sistemi i IA-së në fjalë, kur vendoset në treg ose vihet në shërbim, të mos paraqesë më këtë rrezik pa vonesë të panevojshme, brenda një periudhe që ai mund të përcaktojë.

2. Ofruesi ose operatori tjetër përkatës do të sigurojë që masa korigjuese të merret lidhur me të gjitha sistemet e IA-së në fjalë që ka vënë në dispozicion në tregun e Republikën e Shqipërisë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut të referuar në pika 1.

3. Autoriteti mbikqyres do të informojnë menjëherë autoritetet kompetente për një konstatim sipas pikës 1. Ajo informacion do të përfshijë të gjitha detajet në dispozicion, veçanërisht të dhënat e nevojshme për identifikimin e sistemit IA në fjalë, origjinën dhe zinxhirin e furnizimit të sistemit IA, natyrën e rrezikut të përfshirë dhe natyrën dhe kohëzgjatjen e masave kombëtare të marra.

4. Autoritetet kompetente do të hyjnë pa vonesë të panevojshme në konsultim me operatorët përkatës dhe do të vlerësojë masat kombëtare të marra. Bazuar në rezultatet e këtij vlerësimi, Autoriteti kompetent do të vendosë nëse masa është e justifikuar dhe, kur është e nevojshme, do të propozojë masa të tjera të përshtatshme.

5. Autoriteti kompetent do të komunikojë menjëherë vendimin e tij te operatorët përkatës.

Neni 83

Mos-përputhja formale

1. Kur autoriteti i mbikëqyrjes së tregut konstaton një rëndësi nga gjetjet e mëposhtme, ai do t'i kërkojë ofruesit përkatës të ndalojë mos-përputhjen në fjalë brenda një periudhe që mund të përcaktojë:

- (a) Vënia e markës CE është bërë në shkelje të nenit 48 të këtij ligji;
- (b) Marka CE nuk është vendosur;
- (c) Deklarata e konformitetit së Republikës së Shqipërisë e referuar në nenit 47 të këtij ligji nuk është hartuar;
- (d) Deklarata e konformitetit së Republikës së Shqipërisë e referuar në nenit 47 të këtij ligji nuk është hartuar saktë;
- (e) Regjistrimi në bazën e të dhënave të Republikës së Shqipërisë të referuar në nenit 71 të këtij ligji nuk është kryer;
- (f) Kur është e zbatueshme, nuk është caktuar një përfaqësues i autorizuar;
- (g) Dokumentacioni teknik nuk është në dispozicion.

2. Kur mos-përputhja e referuar në pika 1 vazhdon, autoriteti i mbikëqyrjes do të marrë masa të përshtatshme dhe proporcionale për të kufizuar ose ndaluar vendosjen në dispozicion në treg të sistemit IA me rrezik të lartë, ose për të siguruar tërheqjen ose largimin e tij nga tregu pa vonesë.

Neni 84

Strukturat mbështetëse për testimin e IA në Republikën e Shqipërisë

1. Këshilli i Ministrave do të caktojë një ose më shumë struktura mbështetëse për testimin e IA në Republikën e Shqipërisë sipas legjislationit kombëtar dhe atij ndërkombëtar.

2. Pa u cenuar detyrat e referuara në pika 1, strukturat mbështetëse të testimit të IA në Republikën e Shqipërisë do të ofrojnë gjithashtu këshilla teknike ose shkencore të pavarura me kërkesë të Bordit, autoritetit kompetent ose autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut.

SEKSIONI 4

Masa juridike

Neni 85

E drejta për të depozituar ankesë te autoriteti i mbikëqyrjes së tregut

1. Pa u cenuar mjetet e tjera administrative ose gjyqësore, çdo person fizik ose juridik që ka arsye të konsiderojë se ka pasur shkelje të dispozitave të këtij ligjimund të paraqesë ankesa te autoriteti përkatës i mbikëqyrjes së tregut.
2. Sipas legjislacionit për mbikëqyrjen e tregut, këto ankesa do të merren parasysh për qëllimin e kryerjes së veprimtarive të mbikëqyrjes së tregut, dhe do të trajtohen në përputhje me procedurat e dedikuara të vendosura për këtë nga autoriteti i mbikëqyrjes së tregut.

Neni 86

E drejta për shpjegim të vendimmarrjes individuale

1. Çdo person i prekur nga një vendim që merret nga përdoruesi bazuar në rezultatet e një sistemi i IA-së me rrezik të lartë të listuar në Aneksin III të këtij ligji, me përjashtim të sistemeve të listuara në pikën 2 të tij, dhe i cili prodhon efekte ligjore ose ndikon në mënyrë të ngjashme në mënyrë domethënëse tek ai person, duke e konsideruar këtë ndikim negativ për shëndetin, sigurinë ose të drejtat themelore, ka të drejtë të marrë nga përdoruesi shpjegime të qarta dhe domethënëse mbi rolin e sistemit IA në procedurën e vendimmarrjes dhe elementët kryesorë të vendimit të marrë.
2. Paragrafi 1 nuk zbatohet për përdorimin e sistemeve IA për të cilat përjashtime ose kufizime nga detyrimi i këtij pika rrjedhin nga legjislacioni kombëtar dhe/ose ndërkombëtar.
3. Ky nen zbatohet për atë që drejta e parashikuar në pikën 1 nuk është rregulluar ndryshe nga legjislacioni i posaçëm i Republikës së Shqipërisë.

Neni 87

Raportimi i shkeljeve dhe mbrojtja e personave që raportojnë

1. “Dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve zbatohen për raportimin e shkeljeve të këtij ligji, si dhe për mbrojtjen e personave që raportojnë ose bëjnë publike këto shkelje.”

SEKSIONI 5

Mbikëqyrja, hetimi, zbatimi dhe monitorimi në lidhje me ofruesit e modeleve të IA me qëllim të përgjithshëm

Neni 88

Zbatimi i detyrimeve të ofruesve të modeleve të IA me qëllim të përgjithshëm

1. Këshilli i Ministrave ka kompetenca ekskluzive për të mbikëqyrur dhe zbatuar Kapitullin V, duke marrë parasysh garancitë procedurale sipas nenit 94 të këtij ligji. Këshilli i Ministrave do t'i ngarkojë Zyrës së IA-së zbatimin e këtyre detyrave, pa u cenuar kompetencat organizative të autoritetit kombëtar dhe ndarja e kompetencave midis autoriteteve të tjera Republikën e Shqipërisë

2. Pa u cenuar neni 75, autoritetet e mbikëqyrjes së tregut mund t'i kërkojnë autoritetit kompetent të ushtrojë kompetencat e përcaktuara në këtë Seksion, kur kjo është e nevojshme dhe proporcionale për të ndihmuar në përmbushjen e detyrave të tyre sipas këtij ligji.

Neni 89

Veprimet e monitorimit

1. Për qëllimin e kryerjes së detyrave të ngarkuara nën këtë Seksion, Struktura IA-së mund të marrë masat e nevojshme për të monitoruar zbatimin efektiv dhe konformitetin me këtë Ligj nga ofruesit e modeleve të IA me qëllim të përgjithshëm, duke përfshirë respektimin e tyre ndaj kodeve të miratuara të praktikave.

2. Ofruesit e mëposhtëm (doënstream) kanë të drejtë të paraqesin ankesë duke pretenduar shkelje të këtij ligji. Ankesa duhet të jetë me arsyetim të duhur dhe të tregojë të paktën:

- (a) pikën e kontaktit të ofruesit të modelit të IA me qëllim të përgjithshëm në fjalë;
- (b) një përshkrim të fakteve relevante, dispozitat e këtij ligjiqë janë në fjalë, dhe arsyen pse ofruesi mëposhtëm konsideron se ofruesi i modelit të IA me qëllim të përgjithshëm ka shkelur këtë Ligj;
- (c) çdo informacion tjetër që ofruesi mëposhtëm që ka dërguar kërkesën e konsideron të rëndësishëm, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, informacion të mbledhur në iniciativën e vet.

Neni 90

Alarmet për rreziqe sistemike nga paneli shkencor

1. Paneli shkencor mund të japë një alarm të kualifikuar për Strukturën e IA-së kur ka arsye të dyshojë se:

- (a) një model të IA-së me qëllim të përgjithshëm paraqet një rrezik konkret të identifikueshëm në nivel të Republikës së Shqipërisë; ose
- (b) një model të IA-së me qëllim të përgjithshëm plotëson kushtet e referuara në nenit 51 të këtij ligji.

2. Pas një alarmi të tillë të kualifikuar, Struktura IA-së dhe pasi të ketë informuar Bordin, mund të ushtrojë kompetencat e përcaktuara në këtë Seksion për qëllimin e vlerësimit të çështjes. Struktura IA-së do të informojë Bordin për çdo masë sipas Neneve 91 deri 94.

3. Një alarm i kualifikuar duhet të jetë me arsyetim të duhur dhe të tregojë të paktën:

- (a) pikën e kontaktit të ofruesit të modelit të IA me qëllim të përgjithshëm me rrezik sistematik në fjalë;
- (b) një përshkrim të fakteve relevante dhe arsyet për alarmin nga paneli shkencor;

(c) çdo informacion tjetër që paneli shkencor e konsideron të rëndësishëm, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, informacion të mbledhur në iniciativën e vet.

Neni 91

E drejta për të kërkuar dokumentacion dhe informacion

1. Struktura IA-s mund t'i kërkojë ofruesit të modelit të IA me qëllim të përgjithshëm në fjalë të vërë në dispozicion dokumentacionin e hartuar prej tij në përputhje me nenet 53 të këtij ligji dhe 55, ose çdo informacion shtesë që është i nevojshëm për të vlerësuar konformitetin e ofruesit me këtë Ligj.
2. Para se të dërgojë kërkesën për informacion, Struktura IA-së mund të nisë një dialog të strukturuar me ofruesin e modelit të IA me qëllim të përgjithshëm.
3. Me një kërkesë të arsyetuar nga paneli shkencor, autoriteti kompetent mund të lëshojë një kërkesë për informacion drejtuar një ofruesi të modelit të IA me qëllim të përgjithshëm, kur qasja në informacion është e nevojshme dhe proporcionale për përmbushjen e detyrave të panelit shkencor sipas nenit 68 të këtij ligji.
4. Kërkesa për informacion do të përmbajë bazën ligjore dhe qëllimin e kërkesës, do të specifikojë informacionin e kërkuar, do të caktojë një afat brenda të cilit duhet të jepet informacioni, dhe do të tregojë gjobat e përcaktuara në nenin 97 të këtij ligji për dhënien e informacionit të pasaktë, të paplotë ose të rremë.
5. Ofruesi i modelit të IA me qëllim të përgjithshëm në fjalë, ose përfaqësuesi i tij, duhet të ofrojë informacionin e kërkuar. Në rastin e personave juridikë, kompanive apo firmave, ose kur ofruesi nuk ka personalitet juridik, personat e autorizuar me ligj ose me statutin përkatës do të japin informacionin në emër të ofruesit të modelit të IA në fjalë. Avokatët e autorizuar mund të japin informacion në emër të klientëve të tyre, por klientët mbeten plotësisht përgjegjës nëse informacioni i dhënë është i paplotë, i pasaktë ose i rremë.

Neni 92

E drejta për të kryer vlerësime

1. Struktura IA-së, pas konsultimit me Bordin, mund të kryejë vlerësime të modelit të IA me qëllim të përgjithshëm në fjalë:
 - (a) për të vlerësuar konformitetin e ofruesit me detyrimet sipas këtij ligji, kur informacioni i mbledhur në përputhje me nenin 91 të këtij ligji është i pamjaftueshëm; ose
 - (b) për të hetuar rreziqe sistemike në nivel Republikës së Shqipërisë nga modelet e IA me qëllim të përgjithshëm me rrezik sistematik, veçanërisht pas një alarmi të kualifikuar nga paneli shkencor në përputhje me pikën 1 shkronja (a) të nenit 90 të këtij ligji.
2. Këshilli i Ministrave mund të vendosë të caktojë ekspertë të pavarur për të kryer vlerësimet në emër të tij, duke përfshirë edhe ekspertë nga paneli shkencor i krijuar sipas nenit 68 të këtij ligji. Ekspertët e pavarur të caktuar për këtë detyrë duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 68 të këtij ligji.

3. Për qëllimet e pikës 1, autoriteti kompetent mund të kërkojë qasje në modelin përkatës të IA me qëllim të përgjithshëm përmes API-ve ose mjeteve dhe mënyrave teknike të përshtatshme, përfshirë edhe kodin burimor.

4. Kërkesa për qasje duhet të përmbajë bazën ligjore, qëllimin dhe arsyet e kërkesës, të caktojë afatin për ofrimin e qasjes dhe të tregojë gjobat sipas nenit 95 të këtij ligji për mosdhënie të qasjes.

5. Ofruesit e modelit të IA me qëllim të përgjithshëm në fjalë, ose përfaqësuesit e tyre, duhet të ofrojnë qasjen e kërkuar. Në rastin e personave juridikë, kompanive ose firmave, ose kur ofruesi nuk ka personalitet juridik, personat e autorizuar me ligj ose me statut do të japin qasjen në emër të ofruesit të modelit të IA përkatës.

6. Këshilli i Ministrave do të miratojë akte zbatimi që përcaktojnë rregullat e hollësishme dhe kushtet për vlerësimet, përfshirë edhe mënyrat e përfshirjes së ekspertëve të pavarur dhe procedurën për përzgjedhjen e tyre. Këto akte zbatimi do të miratohen në përputhje me procedurën e shqyrtimit të përmendur në nenin 98 të këtij ligji.

7. Para se të kërkojë qasje në modelin përkatës të IA me qëllim të përgjithshëm, Struktura IA-së mund të nisë një dialog të strukturuar me ofruesin e modelit për të mbledhur më shumë informacion mbi testimin e brendshëm të modelit, masat e brendshme të sigurisë për parandalimin e rreziqeve sistemike dhe procedura apo masa të tjera të brendshme që ofruesi ka ndërmarrë për të zbutur këto rreziqe.

Neni 93

E drejta për të kërkuar masa

Kur është e nevojshme autoriteti kompetent mund t'i kërkojë ofruesve që të:

(a) marrin masa të përshtatshme për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në nenet 53 të këtij ligji dhe 54;

(b) zbatojnë masa zbutëse, kur vlerësimi i kryer në përputhje me nenin 92 të këtij ligji ka sjellë shqetësim serioz dhe të argumentuar për një rrezik sistematik në nivel kombëtar;

(c) kufizojnë vënien në dispozicion në treg, tërheqin ose rikujtojnë modelin.

1. Para se të kërkohet një masë, Struktura e IA-së mund të nisë një dialog të strukturuar me ofruesin e modelit të IA me qëllim të përgjithshëm.

2. Nëse, gjatë dialogut të strukturuar të përmendur në pikën 2, ofruesi i modelit të IA me rrezik sistematik ofron angazhime për të zbatuar masa zbutëse për të adresuar një rrezik sistematik në nivel kombëtar, autoriteti kompetent mund, me vendim, t'i bëjë këto angazhime detyruese dhe të deklarojë se nuk ka më baza për masa të mëtejshme.

Neni 94

Të drejtat procedurale të operatorëve ekonomikë të modelit të AI me qëllim të përgjithshëm

“Për ofruesit e modeleve të IA-së me qëllim të përgjithshëm zbatohen, mutatis mutandis, dispozitat e legjislacionit në fuqi për të drejtat procedurale të operatorëve ekonomikë në fushën e mbikëqyrjes së tregut, me përshtatjet e nevojshme sipas natyrës së modeleve të IA-së me qëllim të përgjithshëm, pa cenuar të drejtat procedurale specifike të parashikuara në këtë ligj.”

KREU X

KODET E SJELLJES DHE UDHËZIMET

Neni 95

Kodet e sjelljes për zbatimin vullnetar të kërkesave specifike

1. Autoritetet kompetente, në bashkëpunim me AKSHI-në si autoritet koordinues teknik, inkurajojnë dhe lehtësojnë hartimin e kodeve të sjelljes, përfshirë mekanizmat përkatës të qeverisjes, me qëllim nxitjen e zbatimit vullnetar, për sistemet e inteligjencës artificiale që nuk klasifikohen si sisteme me rrezik të lartë, të disa ose të gjitha kërkesave të përcaktuara në Kreun III, Seksioni 2, duke marrë në konsideratë zgjidhjet teknike të disponueshme dhe praktikatat më të mira të industrisë.

2. Autoritetet kompetente dhe AKSHI lehtësojnë hartimin e kodeve të sjelljes që lidhen me zbatimin vullnetar të kërkesave specifike për sistemet e inteligjencës artificiale, përfshirë edhe nga përdoruesit e tyre, bazuar në objektiva të qarta dhe tregues të matshëm të performancës për vlerësimin e arritjes së këtyre objektivave, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

a) elemente të zbatueshme të standardeve, parimeve etike dhe praktikave të besueshme për inteligjencën artificiale;

b) vlerësimin dhe minimizimin e ndikimit të sistemeve të inteligjencës artificiale mbi mjedisin dhe qëndrueshmërinë, përfshirë përdorimin efikas të energjisë dhe teknikat për projektim, trajnim dhe përdorim efikas të sistemeve të inteligjencës artificiale;

c) promovimin e njohurive dhe aftësive në fushën e inteligjencës artificiale, veçanërisht për personat e përfshirë në zhvillimin, administrimin dhe përdorimin e sistemeve të inteligjencës artificiale;

d) nxitjen e projektimit gjithëpërfshirës dhe të larmishëm të sistemeve të inteligjencës artificiale, përfshirë përmes përfshirjes së ekipeve me diversitet profesional dhe social, si dhe të palëve të interesuara gjatë procesit të zhvillimit;

e) vlerësimin dhe parandalimin e ndikimeve negative ndaj personave ose grupeve në nevojë për mbrojtje të veçantë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, si dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

3. Kodet e sjelljes mund të hartohen nga ofruesit ose përdoruesit e sistemeve të inteligjencës artificiale, individualisht ose nëpërmjet organizatave që i përfaqësojnë ata, përfshirë me pjesëmarrjen e institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile, institucioneve akademike dhe palëve të tjera të interesuara.

4. Kodet e sjelljes mund të zbatohen për një ose më shumë sisteme të inteligjencës artificiale, duke marrë parasysh qëllimin dhe karakteristikat e tyre të përbashkëta.

5. Gjatë nxitjes dhe lehtësimit të hartimit të kodeve të sjelljes, autoritetet kompetente dhe AKSHI marrin në konsideratë nevojat dhe interesat specifike të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përfshirë ndërmarrjet fillestare (start-up).

Neni 96

Udhëzime për zbatimin e këtij ligji

1. Autoritetet kompetente, në përputhje me fushat e tyre të përgjegjësisë dhe në bashkëpunim me AKSHI-në si autoritet koordinues teknik, mund të hartojnë dhe publikojnë udhëzime për zbatimin praktik të këtij ligji, veçanërisht në lidhje me:

a) zbatimin e kërkesave dhe detyrimeve të përcaktuara në nenet 8 deri në 15 dhe në nenin 25 të këtij ligji;

b) praktikat e ndaluara të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji;

c) zbatimin praktik të dispozitave që lidhen me ndryshimet thelbësore të sistemeve të inteligjencës artificiale;

d) zbatimin praktik të detyrimeve të transparencës të përcaktuara në nenin 50 të këtij ligji;

e) marrëdhënien e këtij ligji me legjislacionin shqiptar të harmonizuar me *acquis* të Bashkimit Evropian, si dhe me legjislacionin kombëtar, me qëllim garantimin e koherencës në zbatimin e tyre;

f) zbatimin e përkufizimit të sistemit të inteligjencës artificiale sipas nenit 3, pika 1, të këtij ligji.

2. Gjatë hartimit të këtyre udhëzimeve, autoritetet kompetente i kushtojnë vëmendje të veçantë nevojave të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përfshirë ndërmarrjet fillestare (start-up), autoriteteve publike dhe sektorëve që mund të preken më shumë nga zbatimi i këtij ligji.

3. Udhëzimet e parashikuara në këtë nen marrin në konsideratë zhvillimet teknologjike në fushën e inteligjencës artificiale, standardet e harmonizuara dhe specifikimet e përbashkëta të miratuara sipas këtij ligji, si dhe standardet ose specifikimet teknike të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

4. Autoritetet kompetente mund të përditësojnë udhëzimet e miratuara sipas paragrafit 1 të këtij neni, me iniciativën e tyre ose me kërkesë të institucioneve përgjegjëse, kur kjo vlerësohet e nevojshme për garantimin e zbatimit efektiv të këtij ligji.

KREU XI

Neni 97

Sanksionet administrative dhe masat e zbatimit

1. Autoritetet kompetente, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, përcaktojnë dhe zbatojnë masa administrative dhe sanksione për shkeljet e dispozitave të këtij ligji nga operatorët, përfshirë paralajmërime, masa korigjuese, kufizime administrative dhe gjoba administrative.
2. Sanksionet dhe masat administrative duhet të jenë efektive, proporcionale dhe parandaluese, duke marrë në konsideratë natyrën e veprimtarisë, interesin publik, si dhe interesat dhe kapacitetet ekonomike të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përfshirë ndërmarrjet fillestare (start-up).
3. Procedurat për vendosjen, ekzekutimin dhe ankimin e sanksioneve administrative sipas këtij ligji kryhen në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.
4. Mosrespektimi i ndalimeve të praktikave të inteligjencës artificiale të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji dënohet me gjobë administrative nga 5 000 000 (pesë milionë) lekë deri në 40 000 000 (dyzet milionë) lekë.
5. Kur shkelësi është person juridik ose ndërmarrje, masa e gjobës mund të përcaktohet deri në 7% të xhiros vjetore të vitit financiar paraardhës, nëse kjo shumë është më e lartë se kufiri maksimal i gjobës së përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni.
6. Mosrespektimi i dispozitave të mëposhtme nga operatorët ekonomikë ose organet e vlerësimit të konformitetit dënohet me gjobë administrative nga 2 000 000 (dy milionë) lekë deri në 20 000 000 (njëzet milionë) lekë, ose deri në 3% të xhiros vjetore të vitit financiar paraardhës, kur kjo shumë është më e lartë:
 - a) detyrimet e ofruesve sipas nenit 16;
 - b) detyrimet e përfaqësuesve të autorizuar sipas nenit 22;
 - c) detyrimet e importuesve sipas nenit 23;
 - d) detyrimet e shpërndarësve sipas nenit 24;
 - e) detyrimet e përdoruesve sipas nenit 26;
 - f) kërkesat dhe detyrimet e organeve të vlerësimit të konformitetit sipas këtij ligji;

g) detyrimet për transparencë sipas nenit 50 të këtij ligji.

7. Dhënia e informacionit të pasaktë, të paplotë ose mashtrues ndaj autoriteteve kompetente ose organeve të vlerësimit të konformitetit dënohet me gjobë administrative nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë ose deri në 1% të xhiros vjetore të vitit financiar paraardhës, kur kjo shumë është më e lartë.

8. Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, përfshirë ndërmarrjet fillestare (start-up), autoritetet kompetente marrin në konsideratë proporcionalitetin e masës administrative dhe ndikimin ekonomik të saj, duke zbatuar kufijtë më të ulët të gjobave të përcaktuara në këtë nen, kur kjo është e përshtatshme.

9. Gjatë përcaktimit të masës administrative ose të gjobës, autoriteti kompetent merr në konsideratë të gjitha rrethanat relevante të rastit konkret, përfshirë:

- a) natyrën, rëndësinë, kohëzgjatjen dhe pasojat e shkeljes;
- b) numrin e personave të prekur dhe nivelin e dëmit të shkaktuar;
- c) masat administrative të vendosura më parë për të njëjtën shkelje;
- d) madhësinë, xhiron vjetore dhe pozicionin në treg të operatorit;
- e) përfitimet financiare ose shmangien e humbjeve si rezultat i shkeljes;
- f) nivelin e bashkëpunimit të operatorit me autoritetet kompetente;
- g) masat teknike dhe organizative të zbatuara për parandalimin ose minimizimin e dëmit;
- h) mënyrën e zbulimit të shkeljes, përfshirë rastet e vetëraportimit;
- i) karakterin e qëllimshëm ose nga pakujdesia të shkeljes;
- j) çdo masë korrigjuese të ndërmarrë nga operatori për zbutjen e pasojave.

10. Autoritetet publike dhe institucionet shtetërore përgjigjen për shkeljet e këtij ligji në përputhje me legjislacionin në fuqi për përgjegjësinë administrative dhe disiplinore.

11. Vendimet për vendosjen e sanksioneve administrative mund të ankimohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat administrative dhe gjykimin administrativ.

12. Zbatimi i masave administrative sipas këtij neni garanton respektimin e parimit të proporcionalitetit, të drejtës për t'u dëgjuar, të drejtës për informim dhe të drejtës për mjete efektive juridike, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin e Procedurave Administrative.

13. Autoritetet kompetente mbajnë regjistër për masat administrative dhe sanksionet e vendosura sipas këtij ligji dhe publikojnë periodikisht informacion statistikor, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit.

Neni 98

Masat administrative ndaj institucioneve dhe autoriteteve publike

1. Autoritetet kompetente, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore, mund të vendosin masa administrative dhe gjoha ndaj institucioneve publike, organeve, agjencive dhe personave juridikë publikë që bien në fushën e zbatimit të këtij ligji.

2. Gjatë përcaktimit të vendosjes së masës administrative dhe të shumës së gjobës, merren në konsideratë të gjitha rrethanat përkatëse të rastit konkret, duke përfshirë:

a) natyrën, rëndësinë, kohëzgjatjen dhe pasojat e shkeljes, duke marrë në konsideratë qëllimin dhe përdorimin e sistemit të inteligjencës artificiale, si dhe numrin e personave të prekur ose nivelin e dëmit të shkaktuar;

b) shkallën e përgjegjësisë së institucionit ose autoritetit publik, duke vlerësuar masat teknike dhe organizative të zbatuara;

c) masat e ndërmarra për të parandaluar ose zbutur dëmin ndaj personave të prekur;

d) nivelin e bashkëpunimit me autoritetin kompetent për korrigjimin e shkeljes dhe minimizimin e pasojave negative;

e) ekzistencën e shkeljeve të mëparshme të ngjashme;

f) mënyrën e evidentimit ose raportimit të shkeljes, përfshirë rastet e vetëraportimit;

g) buxhetin dhe kapacitetet financiare të institucionit ose autoritetit publik.

3. Mosrespektimi i ndalimeve të praktikave të ndaluara të inteligjencës artificiale sipas nenit 5 të këtij ligji dënohet me gjobë administrative deri në 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë.

4. Mosrespektimi i kërkesave ose detyrimeve të tjera të përcaktuara në këtë ligj, përveç atyre të parashikuara në nenin 5, dënohet me gjobë administrative deri në 7 000 000 (shtatë milionë) lekë.

5. Para marrjes së vendimit përfundimtar, autoriteti kompetent garanton të drejtën e institucionit ose autoritetit publik për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur prova, pretendime dhe shpjegime në lidhje me shkeljen e pretenduar, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

6. Vendimi bazohet vetëm mbi faktet, provat dhe rrethanat për të cilat palës i është dhënë mundësia të shprehet.
7. Gjatë procedurës administrative garantohen të drejtat e mbrojtjes dhe e drejta për akses në dokumentacionin administrativ, në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen e sekretit tregtar ose informacionit të klasifikuar.
8. Të ardhurat e mbledhura nga gjobat administrative sipas këtij neni derdhen në Buxhetin e Shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe buxhetor.
9. Vendosja e masave administrative nuk duhet të cenojë ushtrimin normal të funksioneve publike të institucionit ose autoritetit ndaj të cilit është marrë masa.
10. Autoritetet kompetente mbajnë evidencë për masat administrative të vendosura sipas këtij neni dhe publikojnë periodikisht të dhëna statistikore mbi zbatimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 99

Gjobat administrative për ofruesit e modeleve të inteligjencës artificiale me qëllim të përgjithshëm

1. Autoriteti kompetent, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë ligj, mund të vendosë gjoba administrative ndaj ofruesve të modeleve të inteligjencës artificiale me qëllim të përgjithshëm deri në 3% të xhiros totale vjetore të vitit financiar paraardhës ose deri në 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë, cilado që është më e lartë, kur konstaton se ofruesi ka kryer me dashje ose nga pakujdesia një nga shkeljet e mëposhtme:
 - a) ka shkelur dispozitat përkatëse të këtij ligji;
 - b) nuk ka përmbushur kërkesat për paraqitjen e dokumentacionit ose informacionit të kërkuar nga autoriteti kompetent, ose ka paraqitur informacion të pasaktë, të paplotë ose mashtrues;
 - c) nuk ka zbatuar masat administrative ose korrigjuese të urdhëruara nga autoriteti kompetent sipas këtij ligji;
 - d) ka refuzuar ose penguar aksesin e autoritetit kompetent në modelin e inteligjencës artificiale me qëllim të përgjithshëm ose në dokumentacionin teknik të nevojshëm për kryerjen e vlerësimeve dhe verifikimeve përkatëse.

2. Në përcaktimin e masës së gjobës administrative merren në konsideratë natyra, rëndësia, kohëzgjatja dhe pasojat e shkeljes, duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe duke marrë në konsideratë çdo masë korigjuese ose angazhim të ndërmarrë nga operatori për përputhshmëri me këtë ligj.

3. Para marrjes së vendimit për vendosjen e gjobës administrative, autoriteti kompetent i komunikon paraprakisht operatorit të interesuar gjetjet administrative dhe faktet e konstatuara, duke i dhënë mundësinë të paraqesë pretendimet dhe shpjegimet e tij, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

4. Gjobat administrative të vendosura sipas këtij neni duhet të jenë efektive, proporcionale dhe parandaluese.

5. Autoriteti kompetent mban evidencë për masat administrative dhe gjobat e vendosura sipas këtij neni dhe, sipas rastit, informon autoritetet e tjera përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij ligji.

6. Vendimet për vendosjen e gjobave administrative mund të ankimohen në gjykatën kompetente administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjykimin administrativ.

7. Këshilli i Ministrave, me propozim të autoriteteve kompetente, miraton rregulla të hollësishme për procedurat administrative, garancitë procedurale dhe mënyrën e zbatimit të masave dhe gjobave administrative të përcaktuara në këtë nen.

Neni 100

Masat korigjuese

1. Kur konstatohet mospërputhje me këtë ligj, autoriteti i mbikëqyrjes së tregut, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, AKSHI në cilësinë e Strukturës për IA-në ose autoriteti tjetër kompetent i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas fushës së përgjegjësisë, urdhëron operatorin që:

a) të sjellë sistemin IA në përputhje brenda një afati të caktuar;

b) të kufizojë përdorimin e sistemit IA;

c) të pezullojë përkohësisht funksionimin e sistemit;

d) të tërheqë sistemin nga tregu;

e) të ndërpresë përfundimisht përdorimin e sistemit IA.

2. Masat duhet të jenë proporcionale, të arsyetuara dhe në përputhje me nivelin e rrezikut.

Neni 101

E drejta e ankimit

1. Subjekti ka të drejtë:

a) të njihet me aktet;

b) të dëgjohet;

c) të paraqesë prova;

d) të marrë vendim të arsyetuar;

2. Vendimet e autoriteteve kompetente janë të ankueshme në gjykatën kompetente.

3. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit, përveç rasteve kur vendoset ndryshe nga gjykata.

KREU XII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 102

Dispozita kalimtare

1. Sistemet e inteligjencës artificiale që janë hedhur në treg ose janë vënë në shërbim përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji mund të vazhdojnë të përdoren, me kusht që të përputhen me kërkesat e këtij ligji brenda një periudhe tranzitore prej 24 muajsh.

2. Ofruesit dhe përdoruesit e sistemeve IA me rrezik të lartë duhet të përshtatin sistemet e tyre në përputhje me këtë ligj brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

3. Modelet e inteligjencës artificiale me qëllim të përgjithshëm (GPAI) duhet të përmbushin kërkesat përkatëse brenda 12 muajve nga miratimi i akteve nënligjore përkatëse.

4. Autoritetet kompetente krijohen dhe bëhen funksionale brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji

Neni 103

Aktet nënligjore

1. Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij, veçanërisht për nenet 5, 6, 7, 9, 11, 28, 29, 30, 44, 52, 57, 58, 60, 62, 64, 65, 70, 71, 95 dhe 98 të projektligjit, përfshirë: rregullat për përdorimin e sistemeve biometrike në kohë reale; organizimin dhe funksionimin e autoriteteve kompetente; ndryshimin e Aneksit III, IV, VI, VII dhe XIII; funksionimin e sistemit të menaxhimit të rrezikut; procedurat e vlerësimit të konformitetit; kodet e praktikës; krijimin dhe funksionimin e sandbox-it rregullator për IA; metodologjinë e

gjobave administrative; regjistrin kombëtar të sistemeve IA; si dhe çdo rregullim tjetër të nevojshëm për zbatimin e këtij ligji

Neni 104

Shfuqizimet

1. Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, dispozitat e këtij ligji që transpozojnë rregulla të zbatueshme drejtpërdrejt të Rregullores (BE) 2024/1689 shfuqizohen, me përjashtim të dispozitave që rregullojnë organizimin institucional, autoritetet kompetente, bazat e të dhënave/regjistrat kombëtarë, procedurat administrative dhe çështjet për të cilat akti i Bashkimit Evropian u lë hapësirë veprimi shteteve anëtare. Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga data e anëtarësimit, miraton listën e dispozitave që mbeten në fuqi ose shfuqizohen, si dhe aktet nënligjore përkatëse.

Neni 105

Dispozita të veçanta

Ky ligj zbatohet pa cenuar:

1. legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale
2. legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorit
3. legjislacionin për sigurinë e produkteve

Neni 106

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ANEKS I

Ky projektligj është hartuar në përputhje dhe në harmoni me legjislacionin shqiptar në fuqi, në veçanti me:

- Ligjin nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 100/2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2023”;
- Ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligjin nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”;
- Ligjin nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”;
- Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike”;
- . -Ligjin nr. 10325/2010 ose aktet përkatëse– Legjislacionin për bazat e të dhënave shtetërore dhe ndërveprueshmërinë.
- Ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të ndryshuar
- Ligji nr. 10 480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”,
Rregulloret (KE) Nr. 300/2008,
- (BE) Nr. 167/2013,
- (BE) Nr. 168/2013,
- (BE) 2018/858,
- (BE) 2018/1139
- (BE) 2019/2144

Direktivat 2014/90/BE,

(BE) 2016/797

(BE) 2020/1828 (Akt rreth Inteligjencës Artificiale)

ANEKS II

Lista e veprave penale të përmendura në nenit 5 të këtij ligji(1), pika i parë, pika (h)(iii)

Veprat penale të përmendura në nenit 5 të këtij ligji(1), pika i parë, pika (h)(iii):

- i) terrorizmi,
- ii) trafikimi i qenieve njerëzore,
- iii) shfrytëzimi seksual i fëmijëve dhe pornografia me fëmijë,
- iv) trafikimi i paligjshëm i drogave narkotike ose substancave psikotrope,
- v) trafikimi i paligjshëm i armëve, municioneve ose eksplozivëve,
- vi) vrasja, dëmtimi i rëndë trupor,
- vii) tregtia e paligjshme e organeve ose indeve njerëzore, trafikimi i paligjshëm i materialeve bërthamore ose radioactive
- viii) rrëmbimi, mbajtja e paligjshme nën kontroll ose marrja peng
- ix) krime nën juridiksionin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale,
- x) kapja e paligjshme e aeroplanëve ose anijeve,
- xi) përdhunimi,
- xii) krimi mjedisor,
- xiii) grabitje e organizuar ose e armatosur,
- xiv) sabotazhi,
- xv) pjesëmarrja në një organizatë kriminale që merret me një ose më shumë nga veprat e listuara më sipër

ANEKS III

Sistemet e inteligjencës artificiale me rrezik të lartë, të përmendura në nenit 6 të këtij ligji

Sistemet e inteligjencës artificiale (IA) me rrezik të lartë sipas nenit 6 të këtij ligji janë sistemet e IA që përfshihen në ndonjë nga fushat e mëposhtme:

Biometria, sa i përket përdorimit të tyre të lejuar sipas ligjit në Republikën e Shqipërisë

(a) Sistemet për identifikim biometrik në distancë.

Kjo nuk përfshin sistemet e IA që përdoren për verifikim biometrik, që kanë vetëm qëllim konfirmimin se një person i caktuar është personi që pretendon të jetë;

(b) Sistemet e IA të destinuarë për kategorizim biometrik, sipas attributeve ose karakteristikave të ndjeshme ose të mbrojtura, të bazuara në nxjerrjen përfundimesh për këto attribute ose karakteristika;

(c) Sistemet e IA të destinuarë për njohjen e emocioneve.

Infrastruktura kritike: Sistemet e IA të destinuarë për t'u përdorur si komponentë sigurie në menaxhimin dhe funksionimin e infrastrukturës dixhitale kritike, trafikut rrugor, apo në furnizimin me ujë, gaz, ngrohje ose energji elektrike.

Arsimimi dhe trajnimi profesional:

(a) Sistemet e IA të destinuarë për përcaktimin e aksesit ose pranimit, apo për caktimin e personave fizikë në institucione arsimore dhe trajnimi profesional në të gjitha nivelet;

(b) Sistemet e IA të destinuarë për vlerësimin e rezultateve të të nxënës, përfshirë rastet kur këto rezultate përdoren për drejtimin e procesit të të nxënës në institucionet arsimore dhe trajnimi profesional në të gjitha nivelet;

(c) Sistemet e IA të destinuarë për vlerësimin e nivelit të duhur të arsimit që një individ do të marrë ose do të ketë akses, në kontekstin ose brenda institucioneve arsimore dhe trajnimi profesional në të gjitha nivelet;

(d) Sistemet e IA të destinuarë për monitorimin dhe zbulimin e sjelljeve të ndaluara të studentëve gjatë provimeve, në kontekstin ose brenda institucioneve arsimore dhe trajnimi profesional në të gjitha nivelet.

Punësimi, menaxhimi i punonjësve dhe akses në vetëpunësim:

(a) Sistemet e IA të destinuarë për rekrutimin ose përzgjedhjen e personave fizikë, veçanërisht për vendosjen e reklamave të punës të synuara, analizimin dhe filtrimin e aplikimeve për punë, dhe vlerësimin e kandidatëve;

(b) Sistemet e IA të destinuarë për marrjen e vendimeve që ndikojnë marrëdhëniet e punës, promovimin ose ndërprerjen e marrëdhënieve kontraktuale të punës, alokimin e detyrave bazuar në sjelljet individuale ose tiparet personale, apo për monitorimin dhe vlerësimin e performancës dhe sjelljes së personave në këto marrëdhënie.

Akses në shërbime thelbësore private dhe publike dhe përfitime thelbësore:

(a) Sistemet e IA të destinuarë për t'u përdorur nga autoritetet publike ose në emër të tyre për vlerësimin e konformitetit së personave fizikë me kriteret për përfitime dhe shërbime publike thelbësore, përfshirë shërbimet shëndetësore, si dhe për dhënie, uljen, heqjen ose rikthimin e këtyre përfitimeve dhe shërbimeve;

(b) Sistemet e IA të destinuarë për vlerësimin e kredisë së personave fizikë ose për vendosjen e një score kredie, përjashtuar sistemet e IA të përdorura për zbulimin e mashtrimeve financiare;

(c) Sistemet e IA të destinuarë për vlerësimin e rrezikut dhe çmimitarinë në lidhje me personat fizikë në sigurimin e jetës dhe shëndetit;

(d) Sistemet e IA të destinuarë për vlerësimin dhe klasifikimin e thirrjeve emergjente të personave fizikë, apo për përdorim në dërgimin ose përcaktimin e prioritetit në dërgimin e shërbimeve

emergjente të përgjigjes së parë, përfshirë policinë, zjarrfikësit dhe ndihmën mjekësore, si dhe sistemet e triage për pacientët emergjentë.

Zbatimi i ligjit, sa i lejon ligji përkatës i Republikën e Shqipërisëose ligji kombëtar:

- (a) Sistemet e IA të destinuara për t'u përdorur nga autoritetet e zbatimit të ligjit, ose në emër të tyre, ose nga institucionet, organet, Strukturat apo agjencitë e Republikën e Shqipërisë në mbështetje të tyre, për vlerësimin e rrezikut që një person fizik të bëhet viktimë e veprave penale;
- (b) Sistemet e IA të destinuara për t'u përdorur nga autoritetet e zbatimit të ligjit, ose në emër të tyre, apo nga institucionet, organet, Strukturat ose agjencitë e Republikës së Shqipërisë si poligrafë ose mjete të ngjashme;
- (c) Sistemet e IA të destinuara për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmive gjatë hetimit ose ndjekjes penale;
- (d) Sistemet e IA të destinuara për vlerësimin e rrezikut që një person fizik të kryejë ose përsërisë një veprë penale, jo vetëm në bazë të profilizimit sipas nenit 3 të këtij ligji(4), apo për vlerësimin e tipareve të personalitetit, karakteristikave apo sjelljes së mëparshme kriminale të personave ose grupeve;
- (e) Sistemet e IA të destinuara për profilizimin e personave fizikë sipas nenit 3 të këtij ligji(4) gjatë zbulimit, hetimit ose ndjekjes penale.

Menaxhimi i migracionit, azilit dhe kontrollit kufitar, sa i lejon ligji përkatës i Republikën e Shqipërisëose ligji kombëtar:

- (a) Sistemet e IA të destinuara për përdorim nga autoritetet publike kompetente ose në emër të tyre, apo nga institucionet, organet, Strukturat ose agjencitë e Republikës së Shqipërisë si poligrafë ose mjete të ngjashme;
- (b) Sistemet e IA të destinuara për vlerësimin e rrezikut, përfshirë rrezikun e sigurisë, rrezikun e migracionit të parregullt ose rrezikun shëndetësor, që paraqitet nga një person fizik që synon të hyjë ose ka hyrë në territorin e një Shteti Anëtar;
- (c) Sistemet e IA të destinuara për ndihmën ndaj autoriteteve publike kompetente në shqyrtimin e kërkesave për azil, vizë apo leje qëndrimi dhe ankesave përkatëse, për konformitetin e personave fizikë që aplikojnë për status, përfshirë vlerësimet e besueshmërisë së dëshmive;
- (d) Sistemet e IA të destinuara për zbulimin, njohjen ose identifikimin e personave fizikë në kuadër të menaxhimit të migracionit, azilit ose kontrollit kufitar, përjashtuar verifikimin e dokumenteve të udhëtimit.

Administrimi i drejtësisë dhe proceset demokratike:

- (a) Sistemet e IA të destinuara për t'u përdorur nga autoriteti gjyqësor ose në emër të tij për të ndihmuar në hulumtimin dhe interpretimin e fakteve dhe ligjit, dhe në aplikimin e ligjit për një grup konkret faktesh, ose në mënyrë të ngjashme në zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve;
- (b) Sistemet e IA të destinuara për të ndikuar në rezultatin e një zgjedhjeje ose referendumit ose në sjelljen e votimit të personave fizikë gjatë ushtrimit të të drejtës së tyre të votës në zgjedhje ose referendume. Kjo nuk përfshin sistemet e IA ku rezultatet nuk ekspozohen drejtpërdrejt tek

personat fizikë, si mjetet e përdorura për organizimin, optimizimin ose strukturimin e fushatave politike nga pikëpamja administrative ose logjistike.

ANEKS IV

Dokumentacioni teknik i referuar në nenit 11 të këtij ligji(1)

Dokumentacioni teknik i referuar në nenit 11 të këtij ligji(1) duhet të përmbajë së paku informacionin vijues, sipas rastit, për sistemin përkatës të IA-së:

Përshkrimi i përgjithshëm i sistemit të IA-së, duke përfshirë:

- (a) Qëllimin e tij të synuar, emrin e ofruesit dhe versionin e sistemit që tregon lidhjen me versionet e mëparshme;
- (b) Si sistemi i IA-së ndërvepron, ose mund të përdoret për të ndërvepruar me harduerin ose softuerin, përfshirë sistemet e tjera IA që nuk janë pjesë e sistemit IA vetë, ku është e aplikueshme;
- (c) Versionet e softuerit ose firmuerit përkatës, dhe çdo kërkesë lidhur me përditësimet e versioneve;
- (d) Përshkrimin e të gjitha formave në të cilat sistemi i IA-së vendoset në treg ose vihet në shërbim, si paketat e softuerit të integruara në harduer, shkarkimet, ose API-të;
- (e) Përshkrimin e harduerit ku synohet të funksionojë sistemi i IA-së;
- (f) Kur sistemi i IA-së është një komponent i produkteve, fotografitë ose ilustrimet që tregojnë tiparet e jashtme, shënjimimin dhe strukturën e brendshme të atyre produkteve;
- (g) Përshkrimin bazik të ndërfaqes së përdoruesit të ofruar për deployer-in;
- (h) Udhëzimet për përdorim për deployer-in, dhe përshkrimin bazik të ndërfaqes së përdoruesit të ofruar për deployer-in, ku është e aplikueshme.

Përshkrimi i detajuar i elementeve të sistemit IA dhe i procesit të zhvillimit të tij, duke përfshirë:

- (a) Metodatat dhe hapat e kryer për zhvillimin e sistemit IA, duke përfshirë, kur është e rëndësishme, përdorimin e sistemeve ose mjeteve të trajnuara paraprakisht nga palë të treta dhe mënyrën se si ato janë përdorur, integruar ose modifikuar nga ofruesi;
- (b) Specifikimet e dizajnit të sistemit, pra logjika e përgjithshme e sistemit IA dhe e algoritmeve; zgjedhjet kryesore të dizajnit përfshirë arsyetimin dhe supozimet e bëra, përfshirë për personat ose grupet e personave për të cilët sistemi është i destinuar; zgjedhjet kryesore të klasifikimit; për çfarë është projektuar sistemi për të optimizuar, dhe rëndësia e parametrave të ndryshëm; përshkrimi i rezultatit të pritur dhe cilësisë së rezultateve të sistemit; vendimet lidhur me çdo kompromis teknik të bërë për të përmbushur kërkesat e vendosura në Kapitullin III, Seksioni 2;
- (c) Përshkrimi i arkitekturës së sistemit duke shpjeguar se si komponentët e softuerit ndërtohen ose ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe integrohen në përpunimin e përgjithshëm; burimet kompjuterike të përdorura për zhvillim, trajnim, testim dhe validim të sistemit IA;
- (d) Kur është e rëndësishme, kërkesat për të dhëna në termat e fletëve të të dhënave që përshkruajnë metodologjitë dhe teknikat e trajnimit dhe setet e të dhënave të përdorura për

trajnim, përfshirë një përshkrim të përgjithshëm të këtyre seteve të dhënash, informacion rreth origjinës, gamës dhe karakteristikave kryesore; mënyra si janë marrë dhe përzgjedhur të dhënat; procedurat e etiketimit (p.sh. për mësimin e mbikëqyrur), metodologjitë e pastrimit të të dhënave (p.sh. zbulimi i të dhënave anormale);

- (e) Vlerësimi i masave të mbikëqyrjes njerëzore të nevojshme në përputhje me nenin 14 të këtij ligji, përfshirë vlerësimin e masave teknike të nevojshme për të lehtësuar interpretimin e rezultateve të sistemeve IA nga deployer-at, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji(3), pika (d);
- (f) Kur është e aplikueshme, përshkrim i detajuar i ndryshimeve të paracaktuara në sistemin IA dhe performancën e tij, së bashku me gjithë informacionin relevant lidhur me zgjidhjet teknike të adoptuara për të siguruar konformitetin të vazhdueshme të sistemit IA me kërkesat përkatëse të vendosura në Kapitullin III, Seksioni 2;
- (g) Procedurat e validimit dhe testimit të përdorura, duke përfshirë informacion për të dhënat e validimit dhe testimit të përdorura dhe karakteristikat kryesore të tyre; metrikat e përdorura për të matur saktësinë, qëndrueshmërinë dhe konformitetin me kërkesat e tjera përkatëse të vendosura në Kapitullin III, Seksioni 2, si dhe ndikimet potenciale diskriminuese; regjistrat e testimit dhe të gjitha raportet e testimit të datuara dhe të nënshkruara nga personat përgjegjës, përfshirë edhe për ndryshimet e paracaktuara të përmendura në pikën (f);
- (h) Masat e sigurisë kibernetike të vendosura;

ANEKS V

Deklarata e Përputhshmërisë së Republikës së Shqipërisë

Deklarata e konformitetit së Republikës së Shqipërisë, e referuar në nenin 47 të këtij ligji, duhet të përmbajë të gjithë informacionin vijues:

Emri dhe lloji i sistemit IA dhe çdo referencë tjetër e qartë që lejon identifikimin dhe gjurmueshmërinë e sistemit IA;

Emri dhe adresa e ofruesit ose, kur është e aplikueshme, e përfaqësuesit të autorizuar të tyre;

Deklaratë që deklaron konformitetin së Republikës së Shqipërisë, e referuar në nenin 47 të këtij ligji, është nxjerrë nën përgjegjësinë e vetme të ofruesit;

66. Deklaratë që sistemi i IA-së është në përputhje me këtë Ligj dhe, nëse është e aplikueshme, me çdo ligj tjetër relevant në Republikën e Shqipërisë që parashikon nxjerrjen e deklaratës së konformitetit së Republikës së Shqipërisë, e referuar në nenin 47 të këtij ligji;

Kur sistemi i IA-së përfshin përpunimin e të dhënave personale, deklaratë që ai sistem IA përputhet me legjislacionin në fuqi për të dhënat personale;

Referenca për çdo standard të harmonizuar relevant që është përdorur ose çdo specifikim tjetër të përbashkët në lidhje me të cilin bëhet deklarimi i konformitetit;

Kur është e aplikueshme, emri dhe numri i identifikimit të organit të notifikuar, përshkrimi i procedurës së vlerësimit të konformitetit që është kryer, dhe identifikimi i certifikatës së lëshuar;

Vendi dhe data e nxjerrjes së deklaratës, emri dhe funksioni i personit që e ka nënshkruar, si dhe një tregues për kë, ose në emër të kujt, është nënshkruar, dhe nënshkrimi.

ANEKS VI

Procedura e vlerësimit të konformitetit bazuar në kontrollin e brendshëm

Procedura e vlerësimit të konformitetit bazuar në kontrollin e brendshëm është procedura e vlerësimit të konformitetit bazuar në pikat 2, 3 dhe 4.

Ofruesi verifikon që sistemi i menaxhimit të cilësisë i vendosur është në përputhje me kërkesat e nenit 17 të këtij ligji.

Ofruesi shqyrton informacionin e përfshirë në dokumentacionin teknik për të vlerësuar konformitetin e sistemit IA me kërkesat thelbësore përkatëse të përcaktuara në Kapitullin III, Seksioni 2.

Ofruesi gjithashtu verifikon që procesi i dizajnit dhe zhvillimit të sistemit IA dhe monitorimi i tij pas-mbikqyrjes, siç i referohet neni 72, janë në përputhje me dokumentacionin teknik.

ANEKS VII

Përputhshmëria bazuar në një vlerësim të sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe një vlerësim të dokumentacionit teknik

Hyrje

Përputhshmëria bazuar në një vlerësim të sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe një vlerësim të dokumentacionit teknik është procedura e vlerësimit të konformitetit bazuar në pikat 2 deri në 5.

Përmbledhje

Sistemi i miratuar i menaxhimit të cilësisë për dizajnin, zhvillimin dhe testimin e sistemeve IA në përputhje me nenit 17 të këtij ligji do të shqyrtohet në përputhje me pikën 3 dhe do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes siç përcaktohet në pikën 5. Dokumentacioni teknik i sistemit IA do të shqyrtohet në përputhje me pikën 4.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë

3.1. Aplikimi i ofruesit duhet të përfshijë:

- (a) emrin dhe adresën e ofruesit dhe, nëse aplikimi dorëzohet nga një përfaqësues i autorizuar, gjithashtu emrin dhe adresën e tyre;
- (b) listën e sistemeve IA të mbuluara nën të njëjtin sistem të menaxhimit të cilësisë;
- (c) dokumentacionin teknik për secilin sistem IA të mbuluar nën të njëjtin sistem të menaxhimit të cilësisë;
- (d) dokumentacionin lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë që duhet të përfshijë të gjitha aspektet e renditura në nenit 17 të këtij ligji;
- (e) përshkrimin e procedurave në vend për të siguruar që sistemi i menaxhimit të cilësisë mbetet i përshtatshëm dhe efektiv;
- (f) një deklaratë të shkruar që i njëjti aplikim nuk është dorëzuar në ndonjë organ tjetër të njoftuar.

3.2. Sistemi i menaxhimit të cilësisë do të vlerësohet nga organi i notifikuar, i cili do të përcaktojë nëse ai plotëson kërkesat e referuara në nenit 17 të këtij ligji. Vendimi do t'i njoftohet ofruesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar. Njoftimi do të përmbajë përfundimet e vlerësimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

3.3. Sistemi i menaxhimit të cilësisë siç është miratuar do të vazhdojë të zbatohet dhe të mirëmbetet nga ofruesi në mënyrë që të mbetet i përshtatshëm dhe efikas.

3.4. Çdo ndryshim i synuar në sistemin e miratuar të menaxhimit të cilësisë ose në listën e sistemeve IA të mbuluara prej tij do t'i komunikohet organit të notifikuar nga ofruesi. Ndryshimet e propozuara do të shqyrtohen nga organi i notifikuar, i cili do të vendosë nëse sistemi i modifikuar i menaxhimit të cilësisë vazhdon të plotësojë kërkesat e referuara në pikën 3.2 ose nëse është i nevojshëm një rivlerësim. Organi i notifikuar do t'i njoftojë ofruesin për vendimin e tij. Njoftimi do të përmbajë përfundimet e shqyrtimit të ndryshimeve dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

Kontrolli i dokumentacionit teknik

4.1. Përveç aplikimit të referuar në pikën 3, ofruesi do të dorëzojë një aplikim pranë një organi të notifikuar të zgjedhur prej tij për vlerësimin e dokumentacionit teknik që lidhet me sistemin IA që ofruesi ka ndërmend të vendosë në treg ose të vërë në shërbim dhe i cili mbulohet nga sistemi i menaxhimit të cilësisë i referuar në pikën 3.

4.2. Aplikimi do të përfshijë:

(a) emrin dhe adresën e ofruesit;

(b) një deklaratë të shkruar që i njëjti aplikim nuk është dorëzuar në ndonjë organ tjetër të notifikuar;

(c) dokumentacionin teknik të referuar në Aneksin IV të këtij ligji.

4.3. Dokumentacioni teknik do të shqyrtohet nga organi i notifikuar. Kur është e rëndësishme, dhe e kufizuar vetëm në atë që është e nevojshme për të përmbushur detyrat e tij, organit të notifikuar do t'i jepet akses i plotë në setet e të dhënave të trajnimit, validimit dhe testimit të përdorura, duke përfshirë, kur është e përshtatshme dhe në kushtet e masave të sigurisë, përmes API-së ose mjeteve dhe mënyrave teknike përkatëse që mundësojnë akses në distancë.

4.4. Në shqyrtimin e dokumentacionit teknik, organi i notifikuar mund të kërkojë që ofruesi të sigurojë dëshmi shtesë ose të kryejë teste të mëtejshme për të mundësuar një vlerësim të duhur të konformitetit së sistemit IA me kërkesat e përcaktuara në Kapitullin III, Seksioni 2. Në rast se organi i notifikuar nuk është i kënaqur me testet e kryera nga ofruesi, organi i notifikuar do të kryejë vetë drejtpërdrejt testet e përshtatshme, sipas rastit.

4.5. Kur është e nevojshme për të vlerësuar konformitetin e sistemit IA me rrezik të lartë me kërkesat e përcaktuara në Kapitullin III, Seksioni 2, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet e tjera të arsyeshme për verifikimin e konformitetit dhe ato të kenë rezultuar të pamjaftueshme, dhe me një kërkesë të arsyetuar, organit të notifikuar do t'i jepet gjithashtu akses në modelet e trajnimit dhe të trajnuara të sistemit IA, duke përfshirë parametrat e tij përkatës. Ky akses do të jetë në përputhje me ligjet ekzistuese në Republikën e Shqipërisë për mbrojtjen e pronës intelektuale dhe sekretet tregtare.

4.6. Vendimi i organit të notifikuar do t'i njoftohet ofruesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar. Njoftimi do të përmbajë përfundimet e vlerësimit të dokumentacionit teknik dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit. Kur sistemi i IA-së është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kapitullin III, Seksioni 2, organi i notifikuar do të lëshojë një certifikatë të vlerësimit të

dokumentacionit teknik të Republikës së Shqipërisë. Certifikata do të tregojë emrin dhe adresën e ofruesit, përfundimet e shqyrtimit, kushtet (nëse ka) për vlefshmërinë e saj dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e sistemit IA.

Certifikata dhe anekset e saj do të përmbajnë të gjithë informacionin përkatës për të mundësuar vlerësimin e konformitetit të sistemit IA dhe për të lejuar kontrollin e sistemit IA gjatë përdorimit, kur është e aplikueshme.

Kur sistemi i IA-së nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kapitullin III, Seksioni 2, organi i notifikuar do të refuzojë lëshimin e certifikatës së vlerësimit të dokumentacionit teknik në Republikën e Shqipërisë dhe do ta informojë aplikantin në përputhje, duke dhënë arsyet e detajuara për refuzimin.

. Kur sistemi i IA-së nuk plotëson kërkesën lidhur me të dhënat e përdorura për trajnimin e tij, do të jetë i nevojshëm trajnim i ri i sistemit IA para aplikimit për një vlerësim të ri të konformitetit. Në këtë rast, vendimi i arsyetuar i vlerësimit të organit të notifikuar që refuzon lëshimin e certifikatës së vlerësimit të dokumentacionit teknik në Republikën e Shqipërisë do të përmbajë konsiderata specifike mbi cilësinë e të dhënave të përdorura për trajnim të sistemit IA, veçanërisht mbi arsyet e mos-konformitetit.

4.7. Çdo ndryshim në sistemin IA që mund të ndikojë në konformitetin e sistemit IA me kërkesat ose qëllimin e tij të synuar do të vlerësohet nga organi i notifikuar që ka lëshuar certifikatën e vlerësimit të dokumentacionit teknik të Republikës së Shqipërisë. Ofruesi do të informojë organin e tillë të notifikuar për qëllimin e tij për të bërë ndonjë nga ndryshimet e përmendura, ose nëse merr dijeni për ndodhjen e këtyre ndryshimeve. Ndryshimet e synuara do të vlerësohen nga organi i notifikuar, i cili do të vendosë nëse ato kërkojnë një vlerësim të ri të konformitetit në përputhje me nenin 43 të këtij ligji(4) ose nëse mund të trajtohen me anë të një shtese të certifikatës së vlerësimit të dokumentacionit teknik të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast të fundit, organi i notifikuar do të vlerësojë ndryshimet, do ta njoftojë ofruesin për vendimin e tij dhe, kur ndryshimet miratohen, do t'i lëshojë ofruesit një shtesë të certifikatës së vlerësimit të dokumentacionit teknik të Republikës së Shqipërisë.

Mbikëqyrja e sistemit të miratuar të menaxhimit të cilësisë

5.1. Qëllimi i mbikëqyrjes së kryer nga organi i notifikuar i referuar në pikën 3 është të sigurojë që ofruesi përputhet me kushtet dhe kërkesat e sistemit të miratuar të menaxhimit të cilësisë.

5.2. Për qëllime vlerësimi, ofruesi do t'i lejojë organit të notifikuar akses në ambientet ku zhvillohet dizajni, zhvillimi dhe testimi i sistemeve IA. Ofruesi gjithashtu do të ndajë me organin e notifikuar të gjitha informacionet e nevojshme.

5.3. Organi i notifikuar do të kryejë auditime periodike për të siguruar që ofruesi mban dhe zbaton sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe do t'i sigurojë ofruesit një raport auditimi. Në kuadër të këtyre auditimeve, organi i notifikuar mund të kryejë teste shtesë të sistemeve IA për të cilat është lëshuar një certifikatë e vlerësimit të dokumentacionit teknik të Republikës së Shqipërisë.

ANEKS VIII

Informacioni që duhet dorëzuar gjatë regjistrimit të sistemeve të IA me rrezik të lartë në përputhje me nenin 49 të këtij ligji

Seksioni A — Informacioni që duhet dorëzuar nga ofruesit e sistemeve të IA me rrezik të lartë në përputhje me nenin 49 të këtij ligji(1)

Informacioni i mëposhtëm duhet të dorëzohet dhe më pas të mbahet i azhurnuar për sistemet e IA me rrezik të lartë që do të regjistrohen në përputhje me nenin 49 të këtij ligji(1):

Emri, adresa dhe të dhënat e kontaktit të ofruesit;

Kur dorëzimi i informacionit bëhet nga një person tjetër në emër të ofruesit, emri, adresa dhe të dhënat e kontaktit të atij personi;

Emri, adresa dhe të dhënat e kontaktit të përfaqësuesit të autorizuar, kur është e zbatueshme;

Emri tregtar i sistemit IA dhe çdo referencë tjetër e paqartë që mundëson identifikimin dhe gjurmueshmërinë e sistemit IA;

Një përshkrim i qëllimit të synuar të sistemit IA dhe i komponentëve dhe funksioneve të mbështetura nga ky sistem IA;

Një përshkrim bazik dhe i shkurtër i informacionit të përdorur nga sistemi (të dhëna, inpute) dhe logjika e tij e funksionimit;

Statusi i sistemit IA (në treg, ose në shërbim; nuk vendoset më në treg/në shërbim, tërhequr);

Lloji, numri dhe data e skadencës së certifikatës së lëshuar nga organi i notifikuar dhe emri ose numri i identifikimit të atij organi të notifikuar, kur është e zbatueshme;

Një kopje e skanuar e certifikatës së referuar në pikën 8, kur është e zbatueshme;

Çdo Shtet Anëtar në të cilin sistemi i IA-së është vendosur në treg, vënë në shërbim ose është bërë i disponueshëm në Republikën e Shqipërisë;

Një kopje e deklaratës së konformitetit të Republikës së Shqipërisë, të referuar në nenin 47 të këtij ligji;

Udhëzime elektronike për përdorim; ky informacion nuk duhet të jepet për sistemet e IA me rrezik të lartë në fushat e zbatimit të ligjit ose menaxhimit të migracionit, azilit dhe kontrollit kufitar, të referuara në Aneksin III të këtij ligji, pika 1, 6 dhe 7;

Një URL për informacion shtesë (opsionale).

Seksioni B — Informacioni që duhet dorëzuar nga ofruesit e sistemeve të IA me rrezik të lartë në përputhje me nenin 49 të këtij ligji

. Informacioni i mëposhtëm duhet të dorëzohet dhe më pas të mbahet i azhurnuar për sistemet e IA-së që do të regjistrohen në përputhje me nenin 49 të këtij ligji:

Emri, adresa dhe të dhënat e kontaktit të ofruesit;

Kur dorëzimi i informacionit bëhet nga një person tjetër në emër të ofruesit, emri, adresa dhe të dhënat e kontaktit të atij personi;

Emri, adresa dhe të dhënat e kontaktit të përfaqësuesit të autorizuar, kur është e zbatueshme;

Emri tregtar i sistemit IA dhe çdo referencë tjetër e paqartë që mundëson identifikimin dhe gjurmueshmërinë e sistemit IA;

Një përshkrim i qëllimit të synuar të sistemit IA;

Kushti ose kushtet sipas nenit 6 të këtij ligji(3) mbi bazën e të cilave sistemi i IA-së konsiderohet jo me rrezik të lartë;

Një përmbledhje e shkurtër e arsytimit mbi bazën e të cilave sistemi i IA-së konsiderohet jo me rrezik të lartë në zbatimin e procedurës sipas nenit 6 të këtij ligji(3);

Statusi i sistemit IA (në treg, ose në shërbim; nuk vendoset më në treg/në shërbim, tërhequr);

Çdo Shtet Anëtar në të cilin sistemi i IA-së është vendosur në treg, vënë në shërbim ose është bërë i disponueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Seksioni C — Informacioni që duhet dorëzuar nga përdoruesit e sistemeve të IA me rrezik të lartë në përputhje me nenin 49 të këtij ligji(3)

Informacioni i mëposhtëm duhet të dorëzohet dhe më pas të mbahet i azhurnuar për sistemet e IA me rrezik të lartë që do të regjistrohen në përputhje me nenin 49 të këtij ligji(3):

Emri, adresa dhe të dhënat e kontaktit të përdoruesit;

Emri, adresa dhe të dhënat e kontaktit të personit që dorëzon informacionin në emër të përdoruesit;

URL e hyrjes së sistemit IA në bazën e të dhënave të Republikës së Shqipërisë nga ofruesi i tij;

Një përmbledhje e gjetjeve të vlerësimit të ndikimit në të drejtat themelore të kryer në përputhje me nenin 27 të këtij ligji;

Një përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave të kryer në përputhje me nenin 35 të këtij ligji të Ligjs ose nenin 27 të këtij ligji, siç përcaktohet në nenin 26 të këtij ligji(8) të këtij ligji, kur është e zbatueshme.

ANEKS IX

Informacioni që duhet dorëzuar gjatë regjistrimit të sistemeve të IA me rrezik të lartë të listuara në Aneksin III të këtij ligji në lidhje me testimin në kushte reale në përputhje me nenin 60 të këtij ligji

Informacioni i mëposhtëm duhet të dorëzohet dhe më pas të mbahet i azhurnuar në lidhje me testimin në kushte reale që do të regjistrohet në përputhje me nenin 60 të këtij ligji:

Një numër unik identifikimi i vetëm në nivel Republikës së Shqipërisë për testimin në kushte reale;

Emri dhe të dhënat e kontaktit të ofruesit ose ofruesit të ardhshëm dhe të përdoruesve të përfshirë në testimin në kushte reale;

Një përshkrim i shkurtër i sistemit IA, qëllimi i tij i synuar, dhe informacion tjetër i nevojshëm për identifikimin e sistemit;

.Një përmbledhje e karakteristikave kryesore të planit për testimin në kushte reale;

Informacion mbi pezullimin ose përfundimin e testimit në kushte reale.

ANEKS X

Aneksi për sistemet e mëdha të TI-së në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë zbatohet vetëm për atë që aktet përkatëse janë transpozuar ose janë të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare ose akteve të përafrimit.

Sistemi i Informacionit Schengen

.Ligji për të Huajt-Ligji nr. 79/2021 “Për të huajt”

. Ligji për Kontrollin Kufitar-Ligji nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” (i ndryshuar)

Ligji për Policinë e Shtetit-Ligji nr. 108/2014 (i ndryshuar)

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale-Ligji nr. 124/2024 (i ndryshuar)

Marrëveshje ndërkombëtare / acquis Schengen

Shqipëria është në proces përafrimi me:

Schengen acquis

rregulloret e BE për SIS (p.sh. 2018/1860, 1861, 1862)

Sistemi i Informacionit për Vizat

Ligji për të Huajt-Ligji nr. 79/2021

Ligji për Kontrollin Kufitar-Ligji nr. 71/2016

VIS mbështetet në:

Visa Information System Regulation (EC) No 767/2008

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale-Ligji nr. 124/2024 (i ndryshuar)

Sistemi i Hyrjes/Daljes

Ligji nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”, i ndryshuar

Ligji nr. 79/2021- “Për të huajt”

Ligji nr. 108/2014- “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale-Ligji nr. 124/2024 (i ndryshuar)

Regullorja (EU) 2017/2226

Rregullon:

regjistrimin e hyrjes/daljes

tejkalimin e qëndrimit (overstay)

të dhënat biometrike

Visa Information System Regulation (EC) No 767/2008

Sistemi Evropian i Informacionit dhe Autorizimit të Udhëtimit

Ligji nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”, i ndryshuar

Ligji nr. 79/2021- “Për të huajt”

Ligji nr. 108/2014- “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale-Ligji nr. 124/2024 (i ndryshuar)

Rregullorja (BE) 2018/1240 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit,

Rregullorja (BE) 2018/1241 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit,

Sistemi Evropian i Informacionit mbi Rekordet Penale për shtetasit e shteteve të tjera dhe personat pa shtetësi

Ligji nr. 79/2021- “Për të huajt”

Ligji nr. 108/2014- “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale-Ligji nr. 124/2024 (i ndryshuar)

Rregullorja (BE) 2019/816 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 prill 2019, për krijimin e një sistemi të centralizuar për identifikimin e Shteteve Anëtare që mbajnë informacion mbi dënimet për shtetasit e shteteve të tjera dhe personat pa shtetësi (ECRIS-TCN) për të plotësuar Sistemën Evropiane të Informacionit mbi Rekordet Penale dhe ndryshuar Ligjin (BE) 2018/1726 (FZ L 135, 22.5.2019, fq. 1).

ANEKS XI

Dokumentacioni teknik i përmendur në nenin 53 të këtij ligji(1), pika (a) — dokumentacioni teknik për ofruesit e modeleve të inteligjencës artificiale me qëllim të përgjithshëm

Seksioni 1

Informacioni që duhet të jepet nga të gjithë ofruesit e modeleve të IA-së me qëllim të përgjithshëm

Dokumentacioni teknik i përmendur në nenin 53 të këtij ligji(1), pika (a), duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm, sipas rastit dhe në përputhje me madhësinë dhe profilin e rrezikut të modelit:

Përshkrim i përgjithshëm i modelit të inteligjencës artificiale me qëllim të përgjithshëm, përfshirë:

- (a) detyrat që modeli ka për qëllim të kryejë dhe llojin e sistemeve të IA-së në të cilat mund të integrohet;
- (b) politikat e përdorimit të pranueshëm që zbatohen;
- (c) data e publikimit dhe metodat e shpërndarjes;
- (d) arkitektura dhe numri i parametrave;
- (e) modaliteti (p.sh. tekst, imazh) dhe formati i hyrjeve dhe daljeve;
- (f) licenca.

Përshkrim i detajuar i elementeve të modelit të përmendur në pikën 1 dhe informacion përkatës mbi procesin e zhvillimit, përfshirë këto elemente:

- (a) mjetet teknike (p.sh. udhëzimet për përdorim, infrastruktura, veglat) të nevojshme që modeli të integrohet në sisteme të IA-së-je;
- (b) specifikimet e dizajnit të modelit dhe procesit të trajnimit, përfshirë metodologjitë dhe teknikat e trajnimit, zgjedhjet kryesore të dizajnit përfshirë arsyet dhe supozimet e bëra; për çfarë modeli është ndërtuar të optimizohet dhe rëndësinë e parametrave të ndryshëm, sipas rastit;

- (c) informacion mbi të dhënat e përdorura për trajnim, testim dhe validim, kur është e aplikueshme, përfshirë llojin dhe origjinën e të dhënave dhe metodologjitë e përzgjedhjes (p.sh. pastrim, filtrim, etj.), numrin e pikave të të dhënave, përmasën dhe karakteristikat kryesore; mënyrën si janë marrë dhe përzgjedhur të dhënat, si dhe të gjitha masat për të zbuluar papërshtatshmërinë e burimeve të të dhënave dhe metodat për të identifikuar paragjykime të mundshme, kur është e aplikueshme;
- (d) burimet kompjuterike të përdorura për të trajnuar modelin (p.sh. numri i operacioneve me presicion të lartë), koha e trajnimit dhe detaje të tjera të rëndësishme që lidhen me trajnimin;
- (e) konsumimi i njohur ose i vlerësuar i energjisë së modelit.

Shënim: Në lidhje me pikën (e), nëse konsumimi i energjisë së modelit nuk është i njohur, ai mund të bazohet në informacionin për burimet kompjuterike të përdorura.

Seksioni 2

Informacion shtesë që duhet të jepet nga ofruesit e modeleve të IA-së me qëllim të përgjithshëm që përbëjnë rrezik sistemik

Përshkrim i detajuar i strategjive të vlerësimit, përfshirë rezultatet e vlerësimit, bazuar në protokollet dhe veglat publike të disponueshme për vlerësim, ose ndryshe në metodologji të tjera vlerësimi. Strategjitë e vlerësimit duhet të përfshijnë kriteret e vlerësimit, metrikat dhe metodologjinë për identifikimin e kufizimeve.

Kur është e aplikueshme, përshkrim i detajuar i masave të zbatuara për kryerjen e testeve kundërshtuese të brendshme dhe/ose të jashtme (p.sh. teste me grupe të posaçme - “red teaming”), adaptimeve të modelit, përfshirë përafrimin (alignment) dhe përshtatjen e mëvonshme (fine-tuning).

Kur është e aplikueshme, përshkrim i detajuar i arkitekturës së sistemit, duke shpjeguar se si komponentët softuerikë ndërtohen ose ushqehen nga njëri-tjetri dhe integrohen në përpunimin e përgjithshëm.

ANEKSI XII

Informacioni i transparencës sipas nenit 53 të këtij ligji(1), pika (b) — dokumentacioni teknik për ofruesit e modeleve të inteligjencës artificiale me qëllim të përgjithshëm për ofruesit zinxhirë që e integrojnë modelin në sistemin e tyre të IA-së

Informacioni i përmendur në nenin 53 të këtij ligji(1), pika (b) duhet të përmbajë të paktën sa vijon:
1.Përshkrim i përgjithshëm i modelit të inteligjencës artificiale me qëllim të përgjithshëm, duke përfshirë:

- (a)detyrat që modeli synon të kryejë dhe lloji dhe natyra e sistemeve të inteligjencës artificiale në të cilat mund të integrohet;
- (b)politikat e përdorimit të pranueshëm që janë të zbatueshme;
- (c)data e lëshimit dhe metodat e shpërndarjes;
- (d)mënyra se si modeli ndërvepron, ose mund të përdoret për të ndërvepruar, me pajisje harduerike ose softuerike që nuk janë pjesë e vetë modelit, kur është e aplikueshme;

- (e) versionet e softuerëve përkatës që lidhen me përdorimin e modelit të inteligjencës artificiale me qëllim të përgjithshëm, kur është e aplikueshme;
- (f) arkitektura dhe numri i parametrave;
- (g) modaliteti (p.sh. tekst, imazh) dhe formati i të dhënave hyrëse dhe dalëse;
- (h) licensa për modelin.

2. Përshkrim i elementeve të modelit dhe procesit të zhvillimit të tij, duke përfshirë:

- (a) mjetet teknike (p.sh. udhëzime për përdorim, infrastrukturë, vegla) të nevojshme që modeli i inteligjencës artificiale me qëllim të përgjithshëm të integrohet në sistemet e inteligjencës artificiale;
- (b) modaliteti (p.sh. tekst, imazh, etj.) dhe formati i hyrjeve dhe daljeve dhe madhësia e tyre maksimale (p.sh. gjatësia e dritares së kontekstit, etj.);
- (c) informacion mbi të dhënat e përdorura për trajnimin, testimin dhe validimin, kur është e aplikueshme, duke përfshirë llojin dhe origjinën e të dhënave dhe metodologjitë e përpunimit.

ANEKSI XIII

Kriteret për përcaktimin e modeleve të inteligjencës artificiale me qëllim të përgjithshëm me rrezik sistematik sipas nenit 51 të këtij ligji

Për qëllimin e përcaktimit se një model i inteligjencës artificiale me qëllim të përgjithshëm ka aftësi ose ndikim të barasvlerëshëm me ato të përcaktuara në nenin 51 të këtij ligji(1), pika (a), Këshilli i Ministrave do të marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

- (a) numri i parametrave të modelit;
- (b) cilësia ose madhësia e grupit të të dhënave, për shembull e matur përmes numrit të njërive (tokens);
- (c) sasia e llogaritjes së përdorur për trajnimin e modelit, e matur në operacione me presje lundruese (FLOPs) ose e treguar përmes një kombinimi variablesh të tjera, si kostoja e vlerësuar e trajnimit, koha e vlerësuar e nevojshme për trajnimin, ose konsumi i vlerësuar i energjisë për trajnimin;
- (d) modalitetet e hyrjes dhe daljes së modelit, si p.sh. tekst-në-tekst (modelet e mëdha të gjuhës), tekst-në-imazh, multimodaliteti, dhe pragjet më të avancuara për të përcaktuar aftësitë me ndikim të lartë për secilin modalitet, si dhe lloji specifik i hyrjeve dhe daljeve (p.sh. sekuencat biologjike);
- (e) vlerësimet dhe testimet e standardizuara për aftësitë e modelit, përfshirë: numrin e detyrave që mund të kryejë pa trajnim shtesë, përshtatshmërinë për të mësuar detyra të reja e të ndryshme, niveli i autonomisë dhe shkallëzueshmëria, mjetet që ka në dispozicion;
- (f) nëse ka ndikim të lartë në tregun e brendshëm për shkak të shtrirjes së tij, gjë që do të konsiderohet e tillë kur i është vënë në dispozicion të paktën 10,000 përdoruesve të regjistruar me seli në Republikën e Shqipërisë;
- (g) numri i përdoruesve përfundimtarë të regjistruar.

Autoritetet kompetente për zbatimin e këtij ligji janë: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), në cilësinë e autoritetit koordinues dhe Strukturës për IA-në; autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut; Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; autoriteti njoftues; si dhe autoritetet e tjera të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas fushës së përgjegjësisë.